



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 137

Tiranë – E enjte, 23 korrik 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 75/2020, datë 25.6.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 21, datë 27.5.2020, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19””, miratuar me ligjin nr. 30/2020.....	8371
Ligj nr. 80/2020, datë 25.6.2020	Për të Policinë e Burgjeve.....	8371
Dekret i Presidentit nr. 11548, datë 16.7.2020	Për shpallje ligji.....	8386
Ligj nr. 81/2020, datë 25.6.2020	Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.....	8386
Dekret i Presidentit nr. 11547, datë 15.7.2020	Për shpallje ligji.....	8420
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 15.7.2020	Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës.....	8420
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 562, datë 15.7.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Kurbin, Shijak dhe Durrës.....	8422
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 163, datë 16.6.2020	Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e aplikimeve për leje mjedisi të tipit B, për instalimet ekzistuese të pajisura me leje mjedisi të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit prodhues, klasifikohen si leje mjedisi të tipit B, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga QKB-ja.....	8423

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 24.6.2020	Mbi plotësimin e kushteve të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe me nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC, “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, i ndryshuar.....	8425
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 24.6.2020	Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.1.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘HEC Llëngë’ sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Llënga 1’, me fuqi 1730 kw, HEC ‘Llënga 2’, me fuqi 300 kw dhe HEC ‘Llënga 3’”, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw”.....	8426
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 24.6.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw.....	8427
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 102, datë 24.6.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC “Banja”, me kapacitet të instaluar 2 mw.....	8429
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 103, datë 24.6.2020	Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore.....	8431
Kërkesë e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 1026/4, datë 20.7.2020	Për shpronësim, “Për zbatimin e ligjit nr. 10256, datë 25.3.2010 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë ‘Për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë””.....	8432
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 8313, datë 20.7.2020	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	8434

**LIGJ**
Nr. 75/2020

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT NR. 21, DATË
27.5.2020, “PËR DISA NDRYSHIME NË
AKTIN NORMATIV NR. 9, DATË
25.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, ‘PËR MARRJEN E
MASAVE TË VEÇANTA NË FUSHËN E
VEPRIMTARISË GJYQËSORE, GJATË
KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË
EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA
COVID-19”, MIRATUAR ME LIGJIN
NR. 30/2020**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit nr.
21, datë 27.5.2020, “Për disa ndryshime në aktin
normativ nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të
Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta në
fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes
së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-
19”, miratuar me ligjin nr. 30/2020.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 25.6.2020.

LIGJ
Nr. 80/2020**PËR POLICINË E BURGJEVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat dhe parimet e
përgjithshme për:

- organizimin dhe funksionimin e Policisë së
Burgjeve;
- të drejtat dhe detyrat e punonjësit të Policisë
së Burgjeve; si dhe
- marrëdhëniet e punës dhe statusin e
punonjësve të këtij shërbimi.

Neni 2
Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për çdo punonjës të Policisë së
Burgjeve, që ushtron veprimtarinë e tij në nivel
qendror, në institucionet e ekzekutimit të
vendimeve penale, si dhe gjatë transferimeve e
shoqërimeve të personave të dën timer dhe të
paraburgosur.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm
nënkuptojmë:

- “Armë” konsiderohet çdo mjet ose
instrument, sipas kuptimit dhe kategorizimit të
parashikuar në legjislacionin në fuqi për armët.
- “Gatishmëri” konsiderohet gjendja në të cilën
punonjësit e Policisë së Burgjeve mobilizohen dhe
marrin masa të menjëhershme për ruajtjen e



sigurisë së personave dhe të ambienteve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

3. “I burgosur” është personi i paraburgosur ose i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë.

4. “Punonjësi i Policisë së Burgjeve” është punonjësi, i cili ushtron detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse ose ekzekutuese për garantimin e rendit e të sigurisë në IEVP dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

5. “Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP)” janë institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim.

6. “Largim nga Policia e Burgjeve” është ndërprerja e marrëdhënies juridike të punës dhe administrative të punonjësit të Policisë së Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, pa të drejtë rikthimi në Policinë e Burgjeve.

7. “Lirim nga Policia e Burgjeve” është ndërprerja e marrëdhënies juridike të punës dhe administrative të punonjësit të Policisë së Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

8. “Masat për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në IEVP” është tërësia e veprimeve të ligjshme, të cilat duhet të kryhen nga punonjësi i Policisë së Burgjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim garantimin e rendit dhe të sigurisë.

9. “Pajisje kufizuese” janë pajisjet që përdor Policia e Burgjeve në situata të veçanta, me qëllim garantimin e rendit dhe të sigurisë, të përcaktuara në Rregulloren e Burgjeve.

10. “Regjim i brendshëm” janë mjediset e banimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, mjediset e punës, mjediset e veprimtarive profesionale e kulturore dhe ato të përbashkëta.

11. “Regjim i jashtëm” është hapësira ndërmjet murit rrethues e rrethimit perimetrik, si dhe hapësira e sigurisë jashtë rrethimit perimetrik.

12. “Siguri dinamike” janë masat e marra për të siguruar që punonjësit e Policisë së Burgjeve të jenë të trajnuar dhe të nxiten për të krijuar marrëdhënie të mira me të burgosurit, për t’i njohur dhe për t’i kuptuar ata, për t’u ofruar ndihmë për problemet personale, si dhe për t’u përfshirë në dialog me ta.

13. “Situatë emergjente” është një situatë e rrezikshme, e cila përbën një kërcënim serioz, që ndikon ose mund të ndikojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në jetën dhe/apo shëndetin e të dënuarve, të punonjësve të Policisë së Burgjeve, të punonjësve të tjerë apo të personave të tjerë të

pranishëm në IEVP dhe që, në bazë të të dhënave të besueshme, rezulton se nuk mund të përballohet brenda kufijve normalë të menaxhimit e të administrimit të institucionit.

Neni 4

Statusi i Policisë së Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve gëzon status të veçantë sipas këtij ligji.

2. Për çështje që nuk rregullohen nga ky ligj, do të gjejnë zbatim dispozitat e Kodit të Punës.

3. Statusi i Policisë së Burgjeve nuk ndryshon në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore.

KREU II

PARIMET E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMI I POLICISË SË BURGJEVE

SEKSIONI I

PARIMET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË

Neni 5

Ligjshmëria e veprimtarisë

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve kryen detyrat e tij përmes menaxhimit të sigurt dhe njerëzor të të burgosurve dhe ofrimit të mundësisë së rehabilitimit dhe riintegrit të tyre.

2. Në ushtrimin e detyrës, punonjësi i Policisë së Burgjeve trajton me humanizëm, respekt, etikë, si dhe mbron çdo të drejtë dhe liri të çdo të burgosuri.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve të rolit bazë garanton rendin dhe sigurinë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale gjatë shoqërimit ose transferimit të të burgosurit, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me legjislacionin në fuqi.

4. Garantimi i rendit dhe sigurisë, në rastet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, bëhet mes masave dhe mjeteve teknike dhe sigurisë dinamike.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve merr masa për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe të parandalojë çdo veprim që shkakton keqtrajtim ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues.

6. Të drejtat dhe liritë e të burgosurit mund të kufizohen vetëm në rastet dhe mënyrat e



parashikuara në ligj. Në çdo rast kufizimet duhet të jenë proporcionale me qëllimin legjitim për të cilin vendoset.

Neni 6

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij siguron trajtim të barabartë, objektiv për të gjithë të burgosurit dhe shmang diskriminimin për çdo shkak të parashikuar në legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve në trajtimin e të burgosurve mban parasysh veçoritë dhe nevojat moshore, gjinore, aftësitë fizike dhe shëndetësore, si dhe karakteristikat e tjera specifike, që diktojnë një mbrojtje të veçantë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve kryen në çdo kohë detyrat e tij me etikë dhe në mënyrë të tillë që ofron sjellje të mirë në institucion dhe jashtë tij dhe që krijon respekt për të dhe misionin e tij.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve që në formimin fillestar njihet me kodin e etikës, të drejtat dhe liritë e të burgosurve, respektimin dhe mbrojtjen e tyre, si dhe rregullat e vlerësimit të zbatimit të tyre. Rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale përbëjnë pjesë të trajnimit vazhdues të personelit në institucion, përfshirë edhe personelin e Policisë së Burgjeve.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve zbaton me përgjegjësi detyrat e tij dhe nuk duhet të kryejë veprime që mund të krijojnë dyshime për përdorim të papërshtatshëm të shërbimeve që kryejnë.

4. Rregullat e sjelljes dhe udhëzimet më të detajuara të zbatimit të tyre rregullohen në kodin e sjelljes, që miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 8

Kontrolli dhe llogaridhënia

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve është i detyruar të zbatojë urdhrat e dhënë nga eprorët, sipas shkallës funksionale dhe në raporte të

barabarta sipas hierarkisë së gradës. Urdhrat duhet të jepen në përputhje me detyrën funksionale, si dhe të mos jenë në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjin dhe me dinjitetin e personit të cilit i drejtohen.

2. Në rast të një urdhri haptazi të paligjshëm, punonjësi i Policisë së Burgjeve ka detyrimin ligjor të mos e zbatojë urdhrin dhe të raportojë menjëherë paligjshmërinë e urdhrin pranë eprorit të drejtpërdrejtë të personit që ka dhënë urdhrin dhe organeve përgjegjëse për kontrollin e ligjshmërisë së Policisë së Burgjeve.

3. Në mungesë të eprorit të drejtpërdrejtë, në raste urgjente dhe kur nuk ka mundësi të komunikohet me eprorë më të lartë, funksionari me gradë më të lartë ka të drejtën e urdhrin ndaj funksionarëve të barabartë ose më të ulët.

Neni 9

Vazhdimësia e karrierës

Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtën e garantimit të karrierës, të mirëqenies dhe të vazhdimësisë në detyrë.

Neni 10

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Personeli i Policisë së Burgjeve gjatë ushtrimit të detyrës është i detyruar të ruajë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror e hetimor për fakte për të cilat vihet në dijeni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe hetimor.

2. Personelit të Policisë së Burgjeve i ndalohet të bëjë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të të burgosurit, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave për faktet për të cilat vihen në dijeni, në përputhje me pikat 1 e 2 të këtij neni, edhe pasi kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe hetimor.



SEKSIONI II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I POLICISË SË BURGJEVE

Neni 11

Organizimi i Policisë së Burgjeve

1. Policia e Burgjeve funksionon si strukturë administrative e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që ndjek dhe realizon ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve të të burgosurve në gjykata e institucione të tjera, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

2. Struktura dhe organika e Policisë së Burgjeve miratohen si pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të ministrit të Drejtësisë. Pjesë e strukturës dhe e organikës së Policisë së Burgjeve, sipas kësaj pike, është edhe struktura e posaçme që ushtron funksionet përkatëse për garantimin e ruajtjes së rendit dhe të sigurisë në regjimin e posaçëm në institucionin e sigurisë së lartë, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si dhe mbrojtjes së posaçme, sipas pikës 2 të nenit 20 të këtij ligji.

3. Shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe ato të auditimit të brendshëm për Policinë e Burgjeve kryhen nga strukturat përgjegjëse administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 12

Detyrat e Policisë së Burgjeve

1. Policia e Burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ka këto detyra:

a) garanton sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe në institucionet ku shoqërohen apo transferohen të burgosurit;

b) merr masat e sigurisë për zhvillimin e veprimtarive të të burgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

c) kujdeset për shoqërimin dhe sigurinë fizike të të burgosurve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale penale;

ç) zbaton rregullat e sigurisë gjatë shoqërimit apo transferimit të të burgosurve nga një institucion në një tjetër;

d) zbaton rregullat e sigurisë gjatë shoqërimit apo transferimit të të burgosurve për zhvillimin e seancave gjyqësore;

dh) siguron ruajtjen e të burgosurve në spitale publike e private;

e) merr masa për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të personave të burgosur, si dhe për garantimin e rendit e të sigurisë së institucionit në raste të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore;

ë) kontrollon për sende të ndaluara të burgosurit, regjimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe personelin e personat që hyjnë dhe dalin në regjimin e brendshëm;

f) në rastet dhe në përputhje me urdhrin e nxjerrë nga ministri i Drejtësisë, siguron shërbimin e ruajtjes fizike të objekteve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë;

g) vepron vetëm ose bashkëpunon me Policinë e Shtetit ose me struktura të tjera në përballimin e rasteve të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore.

Në rastet e parashikuara në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, Policia e Burgjeve ka detyrimin të marrë masa për të ekspozuar të burgosurin sa më pak që të jetë e mundur para publikut, të marrë masat e duhura mbrojtëse për të siguruar anonimitetin e tij, si dhe të mundësojë lëvizjen e tij në kushte që nuk cenojnë dinjitetin dhe vështirësojnë gjendjen fizike të tij.

2. Përveç detyrave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve ushtron funksionet e mëposhtme:

a) garanton ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në regjimin e posaçëm në institucionin e sigurisë së lartë;

b) parandalon komunikimin e të burgosurve me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera kriminale me të cilat ata bashkëpunojnë jashtë institucionit të vuajtjes së dënimit;

c) parandalon ndërveprimin ndërmjet të burgosurve të tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose organizatave të tjera kriminale me të cilat ata bashkëpunojnë;



ç) parandalon komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të burgosurve, që u përkasin grupeve të tjera kriminale brenda institucionit;

d) mbikëqyr takimet familjare të personave të burgosur, si dhe kontrollojnë korrespondencën e tyre sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trajtimin e të burgosurve.

dh) garanton mbrojtjen e posaçme ndaj punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe drejtuesve të IEVP-ve në rastet kur jeta, familja apo prona e tyre rrezikohet nga veprime të paligjshme për shkak të detyrës që kryejnë ose kanë kryer;

e) kryen çdo funksion tjetër të dhënë sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve.

3. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Policia e Burgjeve përmbush detyrat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, duke mundur realizimin e qëllimit të riintegritetit të të burgosurit në shoqëri pas përfundimit të dënimit.

4. Përcaktimi i ruajtjes fizike të objekteve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë miratohet me urdhër ministri.

Neni 13

Përdorimi i forcës

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të përdorë forcë ndaj personave të dënuar dhe të paraburgosur, me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, ose në rast të rezistencës aktive apo pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Në këto raste forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk ka karakter ndëshkues.

2. Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme. Në çdo rast, ndalohet përdorimi i forcës për qëllime të torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo degradues.

3. Përdorimi i armëve dhe mjeteve të tjera kufizuese gjatë ushtrimit të forcës kryhet në mënyrë të përshkallëzuar dhe në proporcion me situatën dhe nivelin e riskut me të cilin punonjësi i Policisë së Burgjeve përballlet.

4. Personeli që merret drejtpërdrejt me të burgosurit trajnohet paraprakisht, para se të marrë detyrën, për teknikat që bëjnë të mundur

përdorimin minimal të forcës, për të kthyer vetëkontrollin tek të burgosurit agresivë.

5. Përdorimi i forcës ndaj të miturve të dënuar dhe të paraburgosur bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

6. I burgosuri, pas përdorimit të forcës, duhet t'i nënshtrohet ekzaminimit dhe trajtimit mjekësor. Në të gjitha rastet e përdorimit të forcës, punonjësi i Policisë së Burgjeve harton një raport, ku jepen arsyet, faktet dhe rrethanat që kanë diktuar nevojën e përdorimit të forcës.

7. Rregullat e hollësishme për mënyrat, teknikat dhe masat e përdorimit të forcës përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Mbajtja dhe përdorimi i armëve dhe mjeteve të tjera

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, ka të drejtë të mbajë armë dhe pajisje të tjera kufizuese vetëm në rastet dhe sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Punonjësit e strukturës së posaçme në Policinë e Burgjeve, grupet e shoqërimit, përgjegjësit e shërbimit në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe forcat operationale e mbajnë armën në përdorim personal edhe jashtë orëve të shërbimit. Përjashtim bën mbajtja e armës së njësisë, e cila i jepet punonjësit të caktuar përpara fillimit të turnit të shërbimit apo një operationi të caktuar dhe nuk mbahet me vete jashtë orëve të shërbimit.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ndalohet të përdorë armë brenda regjimit të brendshëm të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përveçse në situatat emergjente, sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

4. Në çdo rast ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe i hekurave dhe çdo mjet tjetër që e vendos personin në kushtet e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo degradues. Përdorimi i pajisjeve të tjera kufizuese në regjimin e brendshëm të institucionit lejohet vetëm në raste të veçanta me qëllim:

a) garantimin e rendit dhe sigurisë së institucionit, apo të sigurisë fizike personale apo shëndetit të vetë të burgosurit;



b) parandalimin e arratisjes.

5. Përdorimi i pajisjeve të tjera kufizuese lejohej edhe gjatë një transferimi apo shoqërimi, me kusht që ato të hiqen kur i burgosuri del përpara një organi gjyqësor ose administrativ, me përjashtim të rasteve kur organet e procedimit vendosin ndryshe.

6. Përdorimi i armëve dhe i pajisjeve të tjera kufizuese sipas pikave 1, 2, 3 e 4 të këtij neni, lejohej vetëm pasi punonjësi i Policisë së Burgjeve të ketë përfunduar me sukses trajnimin e detyruar për përdorimin e mjeteve të forcës, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e personelit.

7. Në vendet ku qëndrojnë të miturit e dënuar dhe të paraburgosur, mbajtja dhe përdorimi i pajisjeve kufizuese nga punonjësit e Policisë së Burgjeve bëhen në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

8. Rregullat e hollësishme për përcaktimin e rasteve dhe mënyrës së përdorimit të armëve, të ndryshme nga ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit, si dhe pajisjeve kufizuese, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Bashkëpunimi i Policisë së Burgjeve me strukturat e tjera

1. Në raste të veçanta, kur cenohet rendi dhe siguria në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, Policia e Burgjeve bashkëpunon me strukturat e tjera, që veprojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë.

2. Për rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, punonjësit e strukturave, që veprojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë, hyjnë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale për të trajtuar konflikte sipas rregullave të parashikuara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Marrëveshja, e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, parashikon kushtet dhe të drejtat që kanë punonjësit e secilës strukturë, llojet e ndryshme të forcës që mund të përdoren, rrethanat kur përdoret çdo lloj force, niveli i nevojshëm i kompetencave përpara se të përdoret forca, si dhe raportet që duhet të përgatiten pas përdorimit të forcës.

Neni 16

Kontrolli

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron kontroll në mjedise, si dhe ndaj:

a) të burgosurve;

b) personave që hyjnë brenda perimetrit të sigurisë dhe kanë statusin e vizitorit;

c) personelit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

2. Kontrolli personal kryhet nga punonjës të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar, në praninë e jo më pak se dy punonjësve dhe në mënyrë që shmang mundësinë e shikimit nga punonjësi i gjinisë tjetër.

Kontrolli personal i të burgosurit duhet të jetë në proporcion me nevojën, si dhe mban parasysh respektimin e dinjitetit të personit që kontrollohet, të besimit dhe veçori të tjera të tij.

3. Në çdo rast ndalohej kontrolli intim ndaj personave që i nënshtrohen kontrollit nga ana e punonjësit të Policisë së Burgjeve. Kontrolli intim bëhet vetëm nga mjeku i burgut, kur ka dyshim të arsyeshëm se personi që kontrollohet mund të ketë fshehur sende të ndalura. Kontrolli intim bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve.

4. Kontrolli i të miturve të dënuar ose të paraburgosur bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

5. I nënshtrohen kontrollit edhe sendet personale, që kanë personat që kontrollohen në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Personi që kontrollohet duhet të jetë i pranishëm gjatë kontrollit të sendeve personale të tij, me përjashtim të rasteve kur përdoren mjetet teknike të kontrollit ose prania e personit përbën rrezik për personelin që ushtron kontrollin. Kontrolli personal dhe i sendeve personale të personit mund të bëhet edhe me mjete teknike të kontrollit.

6. Në të gjitha rastet e hyrjeve dhe të kontrolleve në mjedise, punonjësi i Policisë së Burgjeve harton një raport, ku jepen arsyet e hyrjes, të kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij.

7. Rregullat e hollësishme për rastet, llojin dhe mënyrën e ushtrimit të kontrolleve parashikohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.



Neni 17

Kalimi në gatishmëri

1. Në rastet kur të drejtat e të burgosurve kufizohen ose hiqen përkohësisht në grup me urdhër të ministrit të Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, punonjësit e Policisë së Burgjeve kalojnë në gatishmëri.

2. Kalimi në gatishmëri i Policisë së Burgjeve bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të përcaktojë masat që i përgjigjen nivelit të sigurisë në institucion, si dhe nivelit të klasifikimit të gatishmërisë, në përputhje me vlerësimin e rrezikut të situatave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve.

3. Në rastet urgjente dhe në pamundësi të ndjekjes së procedurës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe në mungesë të tij zëvendësi, ka të drejtë të urdhërojë kalimin e menjëhershëm në gatishmëri, me kusht që jo më vonë se 24 orë të marrë miratimin e ministrit të Drejtësisë.

KREU III**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E
POLICISË SË BURGJEVE**

Neni 18

Trajtimi ekonomik dhe financiar

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përfiton trajtimin ekonomik dhe financiar, ku përfshihet:

a) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune;

b) në rast pamundësie të garantimit të transportit në vendin e punës nga vetë institucioni, kompensimi për kostot shtesë për largësi nga vendbanimi, pagesat për transport apo qiranë e banesës dhe ushqimin.

2. Procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Policisë së Burgjeve, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Për atë që nuk është e parashikuar në këtë ligj, punonjësit e Policisë së Burgjeve kanë të drejtën e përfitimit sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të

Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës

Kur punonjësi i policisë humb jetën në krye apo për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë trajtim ekonomik e financiar sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve.

Neni 20

Mbrojtja e veçantë

1. Policia e Shtetit siguron mbrojtje të veçantë fizike për punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit e IEVP-ve, të cilëve për shkak të detyrës që kryejnë ose kanë kryer u rrezikohet jeta, familja apo prona nga veprime të paligjshme të të tretëve.

2. Në situata emergjente, kur për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, është i pamundur garantimi i mbrojtjes nga Policia e Shtetit sipas pikës 1 të këtij neni, me urdhër të ministrit të Drejtësisë ofrohet mbrojtje e veçantë për punonjësit e Policisë së Burgjeve, drejtuesit e IEVP-ve, familjen apo pasurinë e tyre nga struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve.

3. Rastet, kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë për punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit e IEVP-ve, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për punët e brendshme.

4. Rastet, kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë të këtyre punonjësve, sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Drejtësisë.



Neni 21

Kujdesi për gratë shtatzëna

1. Punonjëset shtatzëna ose më fëmijë në gjë nuk mund të kryejnë punë ose shërbime, që mund të dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të fëmijës.

2. Nuk lejohet puna e natës për punonjëset e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 22

E drejta për pushim

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve gëzon të drejtën e pushimit javor, pushimit vjetor të paguar dhe pushimeve të tjera të paguara, të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore në fuqi.

2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për punonjësit e rolit të lartë, të rolit të mesëm, të rolit bazë dhe për punonjësit në cilësinë e aspirantit është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

3. Pushimi vjetor shtyhet kur punonjësi i Policisë së Burgjeve gjatë periudhës së këtij pushimi ka qenë i shtruar në spital ose ka qëndruar në shtëpi për shkak sëmundjeje ose aksidenti, të vërtetuar me raport mjekësor. Ai vë në dijeni për këtë fakt personin përgjegjës në institucion. Pushimi vjetor zgjatet për periudhën e paafësisë së përcaktuar në raportin mjekësor.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, përveç pushimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet e martesës, të lindjes së fëmijës, sëmundjes së rëndë ose vdekjes së bashkëshortit/bashkëshortes bashkëjetuesit/bashkëjetueses, paraardhësve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë të tij, pësimit të dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore, ndërrimit të banesës, ndërrimit të vendbanimit të përhershëm për shkak të detyrës, përgatitjes dhe mbrojtjes së titujve akademikë për punën që kryen.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtë që në raste të veçanta të kërkojë leje pa të drejtë page për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten ose prindërit. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar.

6. Kriteret për dhënie dhe kohëzgjatjen e pushimeve, të parashikuara në pikat 4 e 5 të këtij

neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Të drejtat politike

1. Policia e Burgjeve funksionon si një strukturë e depolitizuar.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk mund të jetë anëtar i partive politike.

3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të shprehë publikisht bindjet ose preferencat e tij politike gjatë kohës së ushtrimit të funksioneve publike

Neni 24

E drejta e anëtarësimit në organizata sindikale

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtën e pjesëmarrjes në organizata sindikale, që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të tij në marrëdhënien e punës.

2. Marrëdhëniet ndërmjet organizatave sindikale dhe punonjësve të Policisë së Burgjeve rregullohen nëpërmjet statutit të sindikatës dhe kartës së të drejtave dhe detyrimeve që pranon çdo punonjës i Policisë së Burgjeve kur anëtarësohet.

3. Të drejtat bazë të punonjësve të Policisë së Burgjeve rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe organizatave sindikale përkatëse.

Neni 25

Ndalimi i grevës

Punonjësit të Policisë së Burgjeve i ndalohet e drejta e grevës.

Neni 26

Detyrimi i përgjegjshmërisë dhe i refuzimit të urdhrave të paligjshëm

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi ose mosveprimi të tij gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit.



3. Në rast se punonjësi i Policisë së Burgjeve e vlerëson urdhrin verbal të paligjshëm, ai kërkon nga eprori i tij që urdhri të jepet edhe me shkrim.

4. Në rast se punonjësi i Policisë së Burgjeve, edhe pas zbatimit të procedurës së parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nga komunikimi i urdhrit deri në dhënien me shkrim të tij, vazhdon të ketë dyshime për paligjshmërinë e urdhrit të eprorit, ai nuk e zbaton atë, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka detyrimin të vërë në dijeni, pa vonesë, organet përkatëse të kontrollit të ligjshmërisë së veprimtarisë të Policisë së Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë, nëse urdhri i dhënë me shkrim, në përputhje me pikën 4 të këtij neni, është në vlerësimin e tij i paligjshëm.

6. Në çdo rast, mosrespektimi i detyrimeve dhe i procedurave, që burojnë nga ky nen, nga punonjësi që ka dhënë, konfirmuar apo zbatuar urdhrin, në rast se nuk përbën vepër penale, përbën shkak për fillimin e hetimit administrativ.

Neni 27

Mbajtja e simboleve gjatë ushtrimit të detyrës

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve detyrohet të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e Policisë së Burgjeve vetëm gjatë kryerjes së detyrës dhe në përputhje me rregullat përkatëse ligjore.

2. Flamuri, stema, uniforma, si dhe ngjyra e shenjat në mjetet e Policisë së Burgjeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

MARRËDHËNIET E PUNËS, PRANIMI NË POLICINË E BURGJEVE DHE TRAJTIMI I PERSONELIT

Neni 28

Marrëdhëniet e punës në Policinë e Burgjeve

1. Marrëdhëniet e punës në Policinë e Burgjeve bazohen në parimet e mundësive të barabarta, të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit. Pranimi në Policinë e Burgjeve kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë.

2. Rregullat dhe procedurat për marrëdhëniet e punës së punonjësve të Policisë së Burgjeve përcaktohen sipas këtij ligji dhe për çështje që nuk rregullohen nga ky ligj, sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

3. Rregullat e detajuara për trajnimin dhe ecurinë në karrierë të punonjësve të Policisë së Burgjeve përcaktohen në rregulloren e personelit, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Drejtësisë.

Neni 29

Kriteret për pranimin në Policinë e Burgjeve

1. Ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve çdo person që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) është shtetas shqiptar;
- b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- c) është në kushte shëndetësore dhe fizike, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- ç) ka mbaruar arsimin e mesëm;
- d) ndaj tij nuk është nisur një procedim penal dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale me dashje;

dh) është person me figurë të pastër morale dhe me integritet shoqëror;

e) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose nuk ka masë disiplinore në fuqi;

ë) është nën moshën 35 vjeç;

f) nuk është larguar nga Policia e Shtetit për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit.

2. Personeli në institucion duhet të ketë një balancim të drejtë mes burrave dhe grave dhe të mbajë parasysh nevojat specifike që ka institucioni.

3. Pranimi në Policinë e Burgjeve bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur kombëtar, që bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve, integritetin, humanizmin, përshtatshmërinë personale për punën komplekse që do të kërkohet nga ata. Pranimi në Policinë e Burgjeve përfshin një testim me shkrim, një testim me gojë, testim psikologjik, si dhe vlerësimin e aftësive fizike e profesionale të kandidatit.



Neni 30 Trajnimi

1. Kandidati i përzgjedhur për t'u pranuar si punonjës i Policisë së Burgjeve, kryen trajnimin fillestar në përputhje me rregullat e parashikuara në rregulloren përkatëse. Pas përfundimit të trajnimit, kandidati ka të drejtë të ushtrojë detyrën për një periudhë njëvjeçare, gjatë së cilës konsiderohet aspirant në Policinë e Burgjeve. Në përfundim të kësaj periudhe, aspiranti konfirmohet ose jo si punonjës i Policisë së Burgjeve.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, pas emërimit në pozicionin përkatës, duhet të ndjekë trajnimin vazhdues të rritjes së aftësive profesionale të Policisë së Burgjeve.

3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, të cilët punojnë me grupe të veçanta të të burgosurve, si: të miturit, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të huajt, persona me nevoja të veçanta, etj., duhet të kryejnë trajnime dhe kualifikime të veçanta në fushat përkatëse.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve i nënshtrohet vlerësimit vjetor nga eprori direkt për mbarrëvajtjen në punë dhe përfitimin e njohurive shtesë.

2. Drejtor i Policisë së Burgjeve mund të emërohet edhe personi që nuk e mban gradën “Drejtues”, me kusht që, përveç kriterëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare jashtë vendit dhe të ketë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë;

b) të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë pune në administratën publike, në polici, në Forcat e Armatosura, në profesionet e lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;

c) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, sipas ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

ç) të mos jetë subjekt i ndalimeve, sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Neni 31 Emërimi i punonjësve të Policisë së Burgjeve

1. Punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm emërohen nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve mbi bazën e propozimit të drejtorit të Policisë së Burgjeve, sipas listës emërore të fituesve në rend zbritës.

2. Punonjësit e rolit të lartë drejtues emërohen nga ministri i Drejtësisë, bazuar në propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 32 Kriteret për emërimin e drejtorit të Policisë së Burgjeve

1. Drejtor i Policisë së Burgjeve emërohet personi që, përveç kriterëve të parashikuara në pikën 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e”, “f”, të nenit 29 të këtij ligji, mban gradën “Drejtues” dhe ka arsim të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 33 Emërimi dhe lirimi i drejtorit të Policisë së Burgjeve

Drejtori i Policisë së Burgjeve emërohet dhe lirohet nga ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimit të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

KREU V TRANSFERIMI DHE KOMANDIMI

Neni 34 Transferimi

1. Transferimi i punonjësit të Policisë së Burgjeve mund të bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozimin me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve, vetëm për nevoja dhe në interes të punës.

2. Transferimi, si rregull, bëhet me pëlqimin e punonjësit.

3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve të rolit bazë dhe të mesëm, që nuk japin pëlqimin për transferim, paraqiten në detyrë, por mund të



ushtrojnë ankim në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Në çdo rast, afati i organit kompetent për t'u shprehur për ankimin nuk mund të jetë më i gjatë se 30 (tridhjetë) ditë.

4. Për punonjësit e rolit bazë transferimi lejohet deri në 45 kilometra larg vendbanimit.

5. Në rastet kur transporti dhe ushqimi nuk sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, punonjësi i transferuar përfiton trajtim financiar sipas parashikimeve të nenit 18 të këtij ligji.

Neni 35 Komandimi

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mund të komandohet me propozimin me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për mbarëvajtjen ose për përballimin e mbingarkesës së punës në sistemin e burgjeve. Periudha e komandimit nuk mund të zgjasë më shumë se 6 (gjashtë) muaj.

2. Gjatë periudhës së komandimit, punonjësit i ruhet vendi i punës dhe përfiton pagën e funksionit për të cilin është emëruar.

3. Punonjësi i komanduar përfiton trajtim financiar, sipas parashikimeve të nenit 18 të këtij ligji, në rastet kur fjetja, transporti dhe ushqimi nuk i sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

KREU VI KLASIFIKIMI I ROLEVE DHE GRADAVE NË POLICINË E BURGJEVE

Neni 36 Rolet në Policinë e Burgjeve

1. Rolet në Policinë e Burgjeve pasqyrojnë nivelin e organizimit, të drejtimit, të kontrollit e të kryerjes së detyrave, si dhe tregojnë pozitën e punonjësve të Policisë së Burgjeve.

2. Rolet ndahen në këto kategori:

- a) roli i lartë;
- b) roli i mesëm;
- c) roli bazë.

Neni 37

Gradat në Policinë e Burgjeve

1. Secila nga kategoritë e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji klasifikohet në grada, të cilat shprehin pozitën që ka punonjësi në strukturën hierarkike të Policisë së Burgjeve.

2. Gradat për punonjësin e rolit të lartë janë:

- a) drejtues i lartë (drejtor i policisë);
- b) drejtues.

3. Gradat për punonjësin e rolit të mesëm janë:

- a) kryekomisar (shëf i sigurisë);
- b) komisar;
- c) nënkomisar.

4. Gradat për punonjësin e rolit bazë janë:

- a) kryeinspektor;
- b) inspektor;
- c) nëninspektor.

Neni 38

Përcaktimi i gradave në funksion

1. Punonjësit e rolit bazë mbajnë gradat si më poshtë:

a) nëninspektorë janë punonjësit e rolit ekzekutiv në detyra mbikëqyrjeje;

b) inspektorë janë punonjësit e rolit bazë me funksione ekzekutive dhe kontrolluese;

c) kryeinspektorë janë punonjësit e rolit bazë në funksione: ndihmës specialistë të policisë, përgjegjës shërbimi në regjimin e posaçëm dhe përgjegjës grupi në forcat operationale.

2. Punonjës të nivelit të mesëm:

a) nënkomisarë janë punonjësit e rolit të mesëm në funksione mbështetje dhe menaxhimi të shërbimeve dhe sigurisë në seksione;

b) komisarë janë punonjësit e rolit të mesëm me funksione menaxhimi dhe drejtimi brenda IEVP-së;

b) kryekomisarë janë punonjësit e rolit të mesëm me funksionin më të lartë drejtues për sigurinë në IEVP, specialist i policisë në DPB dhe trajner në qendrën e trajnimit;

3. Punonjës të rolit të lartë:

a) drejtues janë përgjegjës sektori në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve dhe drejtues i qendrës së trajnimit;

b) drejtues i lartë është drejtori i Policisë së Burgjeve.



Neni 39

Hierarkia e roleve dhe e gradave

1. Hierarkia e punonjësve të Policisë së Burgjeve brenda rolit përcaktohet nga grada më e lartë në gradën më të ulët. Hierarkia e punonjësve të Policisë së Burgjeve ndërmjet roleve përcaktohet nga roli më i lartë te roli më i ulët.

2. Hierarkia e punonjësve të Policisë së Burgjeve me të njëjtën gradë përcaktohet nga funksioni, ndërsa për funksione të njëjta përcaktohet nga vjetërsia në gradë.

Neni 40

Marrja e gradës

1. Marrja e gradës nga punonjësi i Policisë së Burgjeve nënkupton ngritjen e tij në detyrë sipas funksioneve korresponduese për çdo gradë.

2. Grada “Drejtues i lartë” jepet me urdhër të ministrit të Drejtësisë me emërimin në detyrë.

3. Grada “Drejtues” jepet me urdhër të ministrit të Drejtësisë bazuar në propozimin e komisionit të vlerësimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

4. Marrja e gradave për punonjës të rolit të mesëm “Nënkomisar”, “Komisar” dhe “Kryekomisar” bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozim të komisionit të vlerësimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme.

5. Marrja e gradës për rolin bazë jepet nga drejtori i Policisë së Burgjeve, me propozim të komisionit të vlerësimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme.

6. Vendet e lira në strukturën e Policisë së Burgjeve njoftohen sipas rolit, gradës dhe funksionit brenda datës 31 mars të çdo viti, si dhe publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 41

Komisionet e vlerësimit

1. Komisionet e vlerësimit për dhënien e gradave për rolin bazë, të mesëm dhe të lartë propozojnë dhënien e gradave përkatëse në bazë të vlerësimit të kriterëve të parashikuara në këtë ligj për marrjen e gradës.

2. Përbërja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit për dhënien e gradave për rolin bazë dhe

të mesëm përcaktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

3. Përbërja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit për dhënien e gradave për rolin e lartë përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 42

Ecuria në gradë

1. Ecuria në gradë nga “Nëninspektor” deri në “Drejtues” bëhet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) është plotësuar koha e qëndrimit në gradë;
- b) ka përfunduar me sukses trajnimin profesional për marrjen e gradës së radhës;
- c) ka vlerësim vjetor pozitiv të punës për periudhën që ka qëndruar në gradën që mban;
- ç) është shpallur fitues në procedurat konkurruese për ngritjen në gradë.

2. Punonjësit i lind e drejta të shprehë interesin për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes nga momenti i marrjes së gradës, në rast se ka vende të lira, pas plotësimit të kriterëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, sipas afateve të mëposhtme:

- a) punonjësit e rolit bazë:
 - i. nga “Nëninspektor” në “Inspektor” 4 vjet;
 - ii. nga “Inspektor” në “Kryeinspektor” 5 vjet;
 - iii. nga “Kryeinspektor” në “Nënkomisar” 5 vjet.
- b) Punonjësit e rolit të mesëm:
 - i. nga “Nënkomisar” në “Komisar” 3 vjet;
 - ii. nga “Komisar” në “Kryekomisar” 4 vjet.
- c) Punonjësit e rolit të lartë:
 - i. nga “Kryekomisar” në “Drejtues” 5 vjet.

3. Në vjetërsinë, për efekt grade, llogaritet koha gjatë së cilës punonjësi ka kryer shërbim aktiv në strukturat e Policisë së Burgjeve dhe institucione të tjera ligjzbatuese.

4. Procedurat për kryerjen e trajnimit përkatës për marrjen e gradës së radhës përcaktohen në rregulloren e personelit të Policisë së Burgjeve, e cila duhet të përmbajë përbërjen e komisionit të testimit, kriteret për të aplikuar dhe procedurat e aplikimit.

Neni 43

Paraqitja e gradave

Paraqitja, forma dhe ndërtimi i gradave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 44

E drejta e ankimit

1. Në rastet kur punonjësi i rolit bazë dhe të mesëm vëren shkelje të rregullave për ecurinë në gradë, ai ka të drejtë të bëjë ankim te drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

2. Në rastet kur punonjësi i rolit të lartë vëren shkelje të rregullave për ecurinë në gradë, ai ka të drejtë të bëjë ankim te ministri i Drejtësisë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

KREU VII**PROCEDURAT DISIPLINORE**

Neni 45

Masat disiplinore

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mban përgjegjësi administrative për veprimet ose mosveprimet e tij gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj, që bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nëse ato nuk përbëjnë vepër penale. Në këtë rast, ndaj tij mund të jepet njëra nga këto masa disiplinore:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) shtyrje e afatit të ngritjes në gradë për 1 vit;
- ç) largim nga Policia e Burgjeve.

2. Masa disiplinore duhet të jetë në përputhje me shkelljen e kryer, pasojat e ardhura prej saj dhe shkallën e fajësisë.

3. Efektet e masës disiplinore, të dhënë nga organi kompetent, fillojnë pas marrjes dijeni të saj nga personi ndaj të cilit është marrë kjo masë.

4. Vendimi për masën disiplinore duhet t'i komunikohet me shkrim punonjësit të Policisë së Burgjeve brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e saj, duke e vënë në dijeni njëkohësisht edhe për të drejtën e tij të ankimit për vendimin.

5. Kategoritë dhe llojet e shkeljeve disiplinore, kriteret, rregullat, procedurat për dhënien e masave disiplinore, si dhe përbërja, organizimi dhe funksionimi i komisionit të apelimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve përcaktohen në rregulloren e disiplinës, të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 46

Procesi disiplinor

1. Dhënia e masave disiplinore dhe shqyrtimi i tyre bëhen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i njoftohet me shkrim të interesuarit, si dhe bëhet shënimi përkatës në dosjen vetjake.

Neni 47

Autoritetet për dhënien e masave disiplinore

Autoritetet për dhënien e masave disiplinore janë:

a) në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve kryesisht ose me propozimin e drejtorit të Policisë së Burgjeve, për masat disiplinore “Vërejtje me shkrim” dhe “Vërejtje me paralajmërim”;

b) në IEVP, drejtori i IEVP-së kryesisht ose me propozimin e shefit të Policisë së Burgjeve, për masat disiplinore “Vërejtje me shkrim” dhe “Vërejtje me paralajmërim”.

c) ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për punonjësit e rolit të lartë për masën disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit”;

ç) drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozimin me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve, për punonjësit e rolit të mesëm për masën disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit”;

d) drejtori i Policisë së Burgjeve, me propozim të drejtorit të IEVP-së për punonjësit e rolit bazë dhe për punonjësin në periudhë prove në cilësinë e aspirantit, për masën disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit”;

dh) ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për drejtorin dhe përgjegjësit e sektorëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për masën disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve”;

e) Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në bazë të propozimit me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve, për punonjësit e rolit të mesëm, rolit bazë dhe për punonjësin në periudhë prove në cilësinë e



aspirantit për masën disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve”.

Neni 48 Ankimi

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit jepet një masë disiplinore, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 45 të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit të policisë, që ka dhënë masën ndaj tij, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes dijeni për dhënien e masës disiplinore.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret një masë disiplinore, sipas shkronjave “c” dhe “ç” të pikës 1 të nenit 45 të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet me shkrim në komisionin e apelimit të masave disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni me shkrim për dhënien e asaj mase.

Neni 49 Komisioni i apelimit të masave disiplinore

1. Komisioni i apelimit të masave disiplinore krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.

2. Përbërja dhe funksionimi i komisionit caktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

3. Komisioni i apelimit të masave disiplinore ka kompetencë për të lënë në fuqi masën disiplinore, kur e gjen të bazuar, ta shfuqizojë atë, ose të kërkojë rishikimin e saj nga autoriteti që ka dhënë masën.

4. Vendimi përfundimtar për masën disiplinore mund të ankimohet nga punonjësi i Policisë së Burgjeve ndaj të cilit është marrë masa në gjykatën administrative brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 50 Afatet e shuarjes së masës disiplinore

1. Masat disiplinore “Vërejtje me shkrim” dhe “Vërejtje me paralajmërim” qëndrojnë në dosjen personale të punonjësit të Policisë së Burgjeve për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh, periudhë pas së cilës shuhet.

2. Masa disiplinore “Shtyrje e afatit të ngritjes në gradë për 1 vit” qëndron në dosjen personale të punonjësit të Policisë së Burgjeve për një periudhë prej një viti nga data e përfundimit të ekzekutimit të masës, periudhë pas së cilës shuhet.

3. Pas kalimit të periudhave të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, i gjithë dokumentacioni që lidhet me masat disiplinore, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 45 të këtij ligji, hiqen nga dosja personale e punonjësit. Këto të dhëna nuk mund t'i bëhen të ditura asnjë institucioni apo strukture pa lejen me shkrim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

4. Masa disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve” qëndron përgjithmonë në dosjen personale të ish-punonjësit të Policisë së Burgjeve.

Neni 51 Pezullimi

1. Në rastet kur ndaj punonjësit të Policisë së Burgjeve fillon një procedim penal, ai pezullohet nga funksioni deri në përfundim të procesit penal me vendim të formës së prerë. Gjatë kësaj periudhe, punonjësi përfiton 50% të pagës për gradë.

2. Në rastet kur pafajësia rezulton e provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, punonjësi i Policisë së Burgjeve rikthehet në punë dhe kompensohet për pjesën e mbetur të pagës, që duhej të përfitonte nëse nuk do të ishte pezulluar.

KREU VIII PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS NË POLICINË E BURGJEVE

Neni 52 Lirimi nga Policia e Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra kur:

a) deklarohet i paaftë nga ana shëndetësore me vendim të komisionit përgjegjës për përcaktimin e paaftësisë;

b) i shkurtohet funksioni organik dhe nuk pranon të emërohet në funksione të lira të barasvlershme ose më të ulëta në raport me funksionin që kishte;

c) punësohet në struktura të tjera të administratës publike;



ç) nuk kalon testimin në përfundim të kursit bazë të trajnimit;

d) paraqet kërkesë për lirim nga detyra.

2. Drejtori i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra për këto arsye:

a) është në pamundësi shëndetësore për të ushtruar funksionin për më shumë se 6 (gjashtë) muaj;

b) jep dorëheqjen nga detyra.

3. Punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm lirohen nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve mbi bazën e propozimit të drejtorit të Policisë së Burgjeve.

4. Punonjësi i rolit të lartë lirohet nga ministri i Drejtësisë, bazuar në propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 53

Largimi nga Policia e Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve largohet nga detyra nëse dënohet me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e largimit nga Policia e Burgjeve.

2. Largimi i punonjësit të Policisë së Burgjeve bëhet me urdhër të autoritetit kompetent për emërimin e tij, si dhe autoritetit kompetent për dhënien e masës disiplinore të largimit nga Policia e Burgjeve.

Neni 54

Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës përfiton:

a) pagesë kalimtare;

b) pension të parakohshëm suplementar;

c) pension shërbimi;

ç) pension suplementar pleqërie;

d) vjetërsi në punë.

2. Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, sipas rasteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të

punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 55

Përparësia për rikthim dhe pranim në strukturat e Policisë së Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, që gjendet në pagesë kalimtare dhe që plotëson kushtet e kriteret për të vazhduar karrierën policore, nëse është liruar nga detyra për shkak të shkurtimit të funksionit, në çdo rast ka përparësi për t'u rikthyer në shërbim.

2. Kanë përparësi për pranim në Policinë e Burgjeve shtetasit që kanë përvojë pune në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura.

KREU IX

BASHKËPUNIMI ME SUBJEKTE TË TJERA

Neni 56

Informimi i publikut

1. Policia e Burgjeve informon publikun dhe median për kryerjen e detyrave në fushën e rendit dhe të sigurisë publike në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Policisë së Burgjeve i ndalohet që në njoftimet publike të komunikojë në mënyrë jo etike, të cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdiskriminimit dhe dinjtetin e personave të dënuar apo të paraburgosur, veçanërisht të të miturve.

3. Punonjësit të Policisë së Burgjeve i ndalohet të prononcohet në media në mënyrë individuale për çështje të cilat kanë të bëjnë me detyrën.

Neni 57

Bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore

Në përmbushjen e përgjegjësiave të saj, Policia e Burgjeve bashkëpunon me institucionet e administratës shtetërore, me personat fizikë e juridikë.

KREU X
DISPOZITA TË FUNDITNeni 58
Dispozita tranzitore

1. Efektet financiare të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të këtij ligji, për shtesën për çdo vit vjetërsie shërbimi, do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2021.

2. Efektet financiare të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të këtij ligji, për shtesën për natyrë të veçantë pune, do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2022.

3. Efektet financiare të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të këtij ligji, për shtesën për gradë, do të fillojnë të zbatohen nga hyrja në fuqi e ligjit.

4. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr.10 032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, do të qëndrojnë në fuqi dhe do të zbatohen, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore.

Neni 59
Aktet nënligjore zbatuese

1. Ngarkohet Këshilli Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 7; 14, pika 8; 18, pika 2; 22, pika 6; 27, pika 2; 28, pika 3, dhe 43 të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 4; 12, pika 4; 20, pika 4; 41, pika 3; 45, pika 5, dhe 49, pika 2, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

3. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për punët e brendshme të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 20, pika 3, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 60
Shfuqizime

Ligji nr.10 032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 61
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.6.2020

Shpallur me dekretin nr. 11548, datë 16.7.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11548, datë 16.7.2020**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta**

LIGJ
Nr. 81/2020**PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN
E TË DËNUARVE ME BURGIM
DHE TË PARABURGOSURVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:****PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****KREU I****Neni 1
Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve



me burgim, organizimi i sistemit të burgjeve, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente.

Neni 2 Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Anëtarët e familjes” së të paraburgosurit dhe të dënuarit janë bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, fëmijët, gjyshërit, vëllezërit dhe motrat, si dhe bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, bashkëjetesa e të cilëve ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar.

2. “I burgosur” është çdo person i paraburgosur ose i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, që vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale.

3. “I dënuar” është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, i dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë të gjykatave shqiptare ose i dënuar me vendim gjyqësor të dhënë nga gjykatat e huaja, vendim i cili është njohur sipas legjislacionit në fuqi dhe konvertuar dënimi me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare.

4. “I mitur” është çdo person nën moshën 18 vjeç, që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe ndaj të cilit është dhënë masa e sigurisë së arrestit në burg ose një vendim gjyqësor i formës së prerë, që parashikon shprehimisht privimin e lirisë në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale.

5. “Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale” janë institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim.

6. “Institucion i hapur” është institucioni ose seksioni jashtë rrethimit perimetrik të sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, në të cilin i dënuari kryen dënimin me mbikëqyrje dhe

nivel minimal sigurie duke mos u mbyllur në ambientet e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

7. “I paraburgosur” është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, ndaj të cilit është dhënë masë sigurimi “arrest me burg”.

8. “Masë disiplinore” është masa shtrënguese ose ndaluese e dhënë për të paraburgosurin ose të dënuarin në rastet e shkeljeve të parashikuara në këtë ligj.

9. “Raste të veçanta” janë situata të rrezikshme, të cilat përbëjnë një kërcënim serioz, që ndikon ose mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në jetën dhe/ose shëndetin e të burgosurit dhe që në bazë të të dhënave të besueshme rezulton se nuk mund të përballohet brenda kufijve normalë të menaxhimit e të administrimit të institucionit.

10. “Situatë emergjente” përfshin, por pa u kufizuar në to, një prej situatave të mëposhtme:

a) fatkeqësinë natyrore, që vë në rrezik administrimin dhe menaxhimin e institucionit dhe mund të cenojë jetën dhe shëndetin e të burgosurve;

b) sulmet e armatosura nga jashtë institucionit;

c) revoltat masive ose të pjesshme;

ç) tentativat ose arratisjet nga institucioni;

d) përhapjen e sëmundjeve ngjitëse/epidemike;

11. “Torturë” është çdo veprim me anë të të cilit të burgosurit i shkaktohen qëllimisht dhembje ose vuajtje të rënda fizike ose mendore, kur këto dhembje ose vuajtje shkaktohen nga personeli i institucionit ose një person tjetër, që vepron në përmbushje të detyrës zyrtare ose me nxitjen apo pëlqimin e tij, i kryer për një nga qëllimet e parashikuara në Konventën kundër Torturës dhe trajtimit ose ndëshkimeve të tjera mizore, njerëzore ose degraduese.

Neni 4 Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim me vendim penal të formës së prerë të gjykatave shqiptare, si dhe për të paraburgosurit dhe të dënuarit me vendime të gjykatave të huaja në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi.



2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj zbatohen për të gjithë të burgosurit, shtetas shqiptarë, shtetas të huaj dhe personat pa shtetësi.

KREU II PARIMET THEMELORE

Neni 5

Respektimi i të drejtave të njeriut

1. Të burgosurit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues.

2. Të burgosurit trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

3. Të miturit e burgosur trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të tyre. Trajtimi mbështetet në interesin më të lartë të të miturit, të riintegritimit shoqëror, edukimit dhe parandalimit të përsëritjes së veprave penale nga i mituri, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

4. Gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore, që sjell dëmim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, që dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. Të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohej trajtim i barabartë, pa diskriminim, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre kryhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen për kategoritë e personave me çrregullime të shëndetit mendor, jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

6. Të burgosurve me aftësi të kufizuara u garantohej të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, trajtimi pa diskriminim i çdo forme për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre, duke mbajtur parasysh standardet e legjislacionit në fuqi

për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

7. Të burgosurit shtetas të huaj ose persona pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale gjatë transferimit dhe pas liritimit.

8. Masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për respektimin e të drejtave dhe lirive të grupeve të veçanta të të burgosurve, nuk konsiderohen diskriminim në kuptim të këtij ligji.

9. Përveç sa parashikohet në këtë nen, të burgosurit që u përkasin kategorive të marginalizuara trajtohen në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke marrë masa që nevojat e tyre specifike të merren parasysh gjatë qëndrimit në institucion dhe të mbështesin riintegrimin e tyre në shoqëri.

Neni 6

Parandalimi i dhunës dhe trajtimi i viktimës

1. Të burgosurit që ka pasur përvojë të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, i sigurohen menjëherë masa mbrojtje, mbështetje dhe këshillime ligjore, me qëllim rehabilitimin e tij.

2. Personeli i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturve në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për Mitur.

3. Personeli i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale u kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së dinjitetit, nevojave fizike, sociale, profesionale, shëndetësore dhe psikologjike të të burgosurave.

4. Në rastet e ushtrimit të dhunës, autoritetet e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale nisin hetim të pavarur nga strukturat dhe organet kompetente të ngarkuara me ligj, duke respektuar parimin e privatësisë, të mbrojtjes dhe të sigurisë personale.



Neni 7

Trajtimi i ndryshëm i përligjur i të burgosurit

1. Trajtimi i ndryshëm i të burgosurit, në përputhje me kushtet e sigurisë së institucionit për ekzekutimin e vendimeve penale, duhet të jetë i përligjur dhe të rezultojë i nevojshëm për shkak të rrezikshmërisë që paraqet i burgosuri dhe të ketë për qëllim përmbushjen e funksionit rehabilitues të dënimit.

2. Rregullat e detajuara për rastet dhe mënyrën e realizimit të trajtimit të ndryshëm të përligjur të të burgosurit përcaktohen në këtë ligj, në rregulloren e përgjithshme të burgjeve dhe rregulloret e brendshme të çdo institucioni.

Neni 8

Kufizimi individual i të drejtave të të burgosurit

1. Të burgosurit gëzojnë të gjitha të drejtat që nuk u janë kufizuar nëpërmjet vendimeve gjyqësore të dënimit ose të caktimit të masës së sigurisë “arrest me burg”.

2. Të drejtat e të burgosurit, sipas këtij ligji, mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm në rastet dhe sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj.

3. Kufizimi individual i të drejtave sipas këtij neni, nuk mund të cenojë të drejtën e të burgosurit për të komunikuar me mbrojtësin e tij dhe për të paraqitur ankesa në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 9

Kufizimi në grup i të drejtave

1. Të drejtat e të burgosurve mund të kufizohen përkohësisht në grup me urdhër të ministrit të Drejtësisë, në minimumin e nevojshëm, në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm dhe vetëm në rastet e veçanta të:

- a) gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur me ligj;
- b) situatës emergjente;
- c) gjendjes së luftës;
- ç) gjendjes së emergjencës, në përputhje me legjislacionin për emergjencat civile;

d) rreziqeve potenciale për jetën dhe shëndetin e të burgosurve;

dh) sulmeve të armatosura nga jashtë institucionit apo referimit të informacionit për kryerjen e sulmeve të mundshme.

2. Urdhri i ministrit të Drejtësisë për kufizimin në grup të të drejtave të të burgosurve duhet të caktojë llojin dhe masën e të drejtave që kufizon dhe kohëzgjatjen e këtij kufizimi. Në çdo rast, kohëzgjatja e kufizimit të të drejtave vendoset në atë masë dhe për aq kohë sa përligjet nga rrethanat që diktojnë këtë kufizim dhe nuk mund të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e rastit për shkak të të cilit vendoset kufizimi sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Rregullat më të detajuara dhe procedurat për kufizimin në grup të të drejtave dhe kalimin në gatishmëri përcaktohen në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.

4. Kufizimi në grup i të drejtave sipas këtij neni, nuk mund të cenojë të drejtën e të burgosurve për të komunikuar me mbrojtësin e tij dhe për të paraqitur ankesa në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 10

E drejta e ankimit dhe paraqitjes së kërkesave

1. Të burgosurit, individualisht ose në grup, kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe ankesa për zbatimin e këtij ligji, legjislacionit në fuqi, të rregullores së përgjithshme të burgjeve, si dhe të rregullores së brendshme të institucioneve.

2. Kërkesa dhe ankesa paraqiten drejtpërdrejt në organin kompetent, në çdo zyrë ose degë të tij, në formë të shkruar ose në çdo formë tjetër të përshtatshme. Kur kërkesa dhe ankesa paraqiten verbalisht, institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mban procesverbal për dokumentimin e kërkesës ose ankesës së paraqitur.

3. I burgosuri, kur e çmon të nevojshme, mund t'i drejtohet cilitdo organi shtetëror ose organizate jofitimprurëse brenda dhe jashtë vendit.

4. Personeli i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale vë në dispozicion të të burgosurit mjetet e nevojshme për paraqitjen e kërkesës dhe ankesës.



Neni 11

Veprat penale të kryera nga të burgosurit

I burgosuri, kur hetohet dhe/ose gjykohet për një vepër tjetër penale gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit, vazhdon të qëndrojë në institucionin ku po ekzekutohet vendimi i mëparshëm, përveç rasteve kur prokurori dhe/ose gjykata vendos ndryshe.

**KREU III
TRAJTIMI**

Neni 12

Rehabilitimi social dhe riintegrimi

1. Trajtimi i të burgosurit synon rehabilitimin për riintegrimin e tij në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale.

2. Plani individual i trajtimit hartohet nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale dhe ofrohet prej tyre ose në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimet e arsimit, formimit profesional, punësimit dhe organizatat jofitimprurëse. Plani individual i trajtimit mund të ndryshojë duke iu përshtatur përparimit të arritur dhe rrethanave të tjera. I burgosuri inkurajohet që të bashkëpunojë në realizimin e programeve dhe aktiviteteve riedukuese në institucion.

3. Institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat jofitimprurëse hartojnë programe rehabilitimi dhe programe riintegrimi praglirimi për adresimin e nevojave të posaçme të secilit të burgosur.

4. Në rastin e të burgosurit të mitur, personeli i institucioneve të ekzekutimeve të vendimeve penale, i ofron të miturit ndihmë sociale, edukative, arsimore, psikologjike, mjekësore në përshtatje me nevojat individuale dhe në përputhje me grup-moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në jetën shoqërore.

5. Për qëllimet e zbatimit të pikës 4 të këtij neni, personeli i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur harton një program rehabilitimi

dhe riintegrimi në bashkëpunim me të miturin, familjen e tij dhe strukturat e mbrojtjes së të miturit. Programi i rehabilitimit dhe riintegritit të të miturit hartohet dhe njoftohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

6. Për të burgosurit që u përkasin pakicave kombëtare, të burgosurit e huaj ose persona pa shtetësi, përgatiten, për aq sa është e mundur, programe që respektojnë kulturën e tyre. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale bashkëpunon me institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare që punojnë me këto kategori.

Neni 13

Individualizimi i trajtimit

1. Trajtimi i të burgosurit kryhet në përputhje me gjendjen dhe nevojat individuale të tij.

2. Individualizimi i trajtimit bëhet duke vlerësuar nevojat individuale, psikologjike, shoqërore, gjinore, të moshës, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i burgosuri, faktorët e riskut dhe motivimin për t'u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion.

3. Vlerësimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit të dënimit, duke e përshtatur trajtimin sipas nevojave të të burgosurit.

Neni 14

Plani individual i trajtimit

1. Pas procesit të vlerësimit hartohet plani individual i trajtimit në bashkëpunim me të burgosurin. Ky plan duhet të përfshijë programin e trajtimit, të rehabilitimit dhe riintegritit për çdo të burgosur. Për kategoritë e veçanta të të burgosurve plani individual i trajtimit hartohet duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike të tyre.

2. Rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psikosocial të të burgosurve të mitur, të rinjve të moshës 18 deri 21 vjeç, grave, personave me çrregullime të shëndetit mendor, të pasura ose të fituara gjatë burgimit, personave me aftësi të kufizuara, personave me orientim seksual të ndryshëm, personave me sëmundje kronike ose



nën varësi të drogës, të moshuarve, personave të dënuar me dënime afatgjata, personave që u përkasin pakicave kombëtare, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi.

3. Për çdo të mitur të burgosur përgatitet një program individual rehabilitimi dhe riintegrimi, i cili merr në konsideratë arsimin e tij, vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, dëshirat dhe mundësitë e tij/saj për të ndjekur arsimin e përgjithshëm dhe/ose arsimin profesional mundësisht jashtë mjediseve të paraburgimit dhe burgimit, trajnime profesionale sipas interesave dhe prirjeve të tyre dhe që do të ndihmojnë në punësimin e tyre pas largimit nga institucioni. Për të burgosurit e mitur, që kanë vështirësi të të mësuarit ose të nxënies që lidhen me aftësinë e kufizuar, si dhe për të miturit që nuk kanë ndjekur shkollën organizohen programe të veçanta dhe individuale të arsimit. Plani individual i trajtimit hartohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur nga grupi shumëdisiplinar, i cili funksionon pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur dhe mbikëqyrjet nga punonjësi social. I mituri pyetet dhe jep pëlqimin për planin individual të trajtimit sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

4. Për të burgosurin e ri të moshës 18 deri 21 vjeç përgatitet një plan individual trajtimi, ku përfshihet trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i tij. Ky plan i siguron arsimin bazë të detyrueshëm dhe/ose arsimin profesional mundësisht jashtë mjediseve të paraburgimit dhe burgimit dhe, sipas rastit, edhe arsimin e mesëm ose të lartë. Personeli i institucionit i krijon mundësi për trajnim profesional sipas interesave dhe prirjeve të tij dhe ndihmon në punësimin e tij pas daljes nga institucioni.

5. Vlerësimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga personeli i institucionit në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse.

6. Personeli i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale inkurajon dhe mbështet kontributin e organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë në realizimin e planit individual të trajtimit.

7. Ministria e Drejtësisë mbështet programe kërkimi dhe vlerësimi rreth funksionimit të sistemit të burgjeve, rolit të tij në riintegrimin e të dënuarit në shoqëri.

8. Për qëllime në zbatim të këtij neni Ministria e Drejtësisë lidh marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional ose me organizata dhe agjenci të akredituara në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të burgosurve.

9. Rregullat e detajuara për hartimin, zhvillimin dhe realizimin e planit individual të trajtimit miratohen nga ministri i Drejtësisë, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

PJESA E DYTË INSTITUCIONET

KREU I LLOJET E INSTITUCIONEVE

Neni 15

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, mbi bazën e kategorisë së subjekteve ndaj të cilave ekzekutohen vendimet penale, ndahen në:

- a) institucione për të dënuarit e rritur;
- b) institucione për të dënuarit e mitur;
- c) institucione për gratë;
- ç) institucione të paraburgimit;
- d) institucione të kujdesit shëndetësor për të burgosurit;

2. Institucionet e kujdesit shëndetësor për personat për të cilat gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme administrohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor, për sa i takon ofrimin të shërbimeve. Masat e sigurisë për ruajtjen e këtyre institucioneve ofrohen nga Ministria e Drejtësisë.

3. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të ndahen në seksione sipas nevojës së administrimit.

4. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ose seksione brenda tyre, mbi bazën e sigurisë, kategorizohen si më poshtë:

- a) institucione të sigurisë së lartë;
- b) institucione të sigurisë së zakonshme;
- c) institucione të sigurisë së ulët;
- ç) institucione të hapura.



5. Përjashtimisht nga rregullat e përcaktuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore, krijimi, klasifikimi dhe mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim ose seksioneve të veçanta në këto institucione bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 16

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë janë institucionet ku ekzekutohen vendimet me burgim:

a) për çdo vepër penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

b) për veprat penale për të cilat Kodi Penal parashikon dënimin me burgim të përjetshëm;

c) për veprat penale të kryera nga përsëritësit, për të cilat gjykata ka dhënë një dënim jo më të vogël se pesëmbëdhjetë vjet burgim;

ç) për krimet kundër jetës, për të cilat gjykata ka dhënë një dënim jo më të vogël se njëzet vjet burgim;

d) për krimet seksuale me të mitur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal.

2. Përveç sa është parashikuar më sipër, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë ekzekutohet dënimi edhe ndaj të dënuarve të tjerë, të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë ekzekutimit të dënimit janë karakterizuar nga qëndrime ose sjellje që e bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera.

3. Caktimi fillestar i të dënuarit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë kryhet nga gjykata që ka dhënë vendimin e dënimit me burgim. Në rastet kur gjykata nuk ka caktuar në vendim kategorinë e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe i dënuari në kryerjen e veprës penale është karakterizuar nga qëndrime e sjellje që e bëjnë të pamundur qëndrimin në institucionet e sigurisë së zakonshme, me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të caktojë që ekzekutimi i vendimit të dënimit të kryhet në një institucion të sigurisë së lartë. Në këto raste, prokurori, menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se 48 orë

nga marrja dijeni për vendimin e gjykatës, paraqet kërkesën për caktimin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë.

4. Ndryshimi i klasifikimit të sigurisë për të dënuarit që vuajnë dënimin në institucionin e sigurisë së lartë dhe për të dënuarit, të cilët gjatë ekzekutimit të dënimit janë karakterizuar nga qëndrime ose sjellje që e bëjnë të pamundur qëndrimin në institucionet e kategorive të tjera dhe duhet të kalojnë në një institucion të sigurisë së lartë, bëhet nga gjykata në bazë të kërkesës së të dënuarit, mbrojtësit ose prokurorit. Prokurori vihet në lëvizje me kërkesë të drejtuesit të institucionit. Gjykata i kërkon komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë të paraqesë një raport të vlerësimit të rrezikshmërisë mbështetur në raportin e vlerësimit të riskut të sigurisë, të hartuar nga institucioni i ekzekutimit të vendimit penal ku i dënuari kryen dënimin.

5. Gjatë shqyrtimit të çështjes nga gjykata, i dënuari qëndron në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë.

6. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë vihen kufizime në të drejtat e të dënuarit, në rastet dhe sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 17

Regjimi i posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë

1. Në raste të veçanta mund të zbatohet një regjim i posaçëm i ushtrimit të të drejtave për të dënuarit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që hetohen ose gjykohen për veprat penale të parashikuara në nenet 79, shkronja “ç”, 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 265/a, 265/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste.

2. Pavarësisht nga sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, regjimi i posaçëm mund të zbatohet edhe ndaj të burgosurve të cilët kanë rrezikshmëri



të lartë për shkak të lidhjeve me pjesëtarët e organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura ose të grupeve të strukturuar kriminale.

3. Vendimi për vendosjen e të burgosurit në regjimin e posaçëm në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë merret nga ministri i Drejtësisë mbi kërkesën e arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Për marrjen e këtij vendimi, ministri i Drejtësisë bazohet në konsultimin me ministrin e Brendshëm, në të dhënat/informacionet e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimit Informativ të Shtetit, drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë.

4. Vendosja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë bazohet vetëm në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë ose me organizata të tjera, të referuara në pikën 1 të këtij neni, nëpërmjet marrjes së masave të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë, që lidhen kryesisht me nevojën për të parandaluar:

a) kontaktet me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë;

b) konfliktet e mundshme me elementë të organizatave të tjera;

c) ndërveprimin me të burgosurit e tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose organizatave të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë;

ç) komunikimin ose shkëmbimin e sendeve ndërmjet të burgosurve që u përkasin grupimeve të ndryshme.

5. Regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave konsiston në:

a) lejimin e një takimi në muaj me anëtarë të familjes, i cili kryhet në intervale të rregullta kohore dhe në mjedise të caktuara, ku ndalohet hyrja e personave ose sendeve të tjera dhe që i nënshtrohen regjistrimit audio dhe video. Takimi me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, për personat e dënuar, lejohet me propozimin e drejtorit të institucionit dhe me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Për personat e paraburgosur, takimi me persona të ndryshëm

nga anëtarët e familjes lejohet vetëm me miratimin e prokurorit. Parashikimet e kësaj shkronje nuk zbatohen për takimet me mbrojtësit;

b) lejimin e të burgosurit për kryerjen e një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet. Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve pas propozimit të drejtorit të institucionit, ndërsa për personat e paraburgosur autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit. Parashikimet e kësaj shkronje nuk zbatohen për kryerjen e bisedave telefonike me institucionin e Avokatit të Popullit dhe me organizata vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut;

c) ndalimin e përdorimit të vlerave monetare, sendeve dhe objekteve, që mund të marrë i burgosuri nga jashtë, sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme të institucionit;

ç) kontrollin e korrespondencës, përveç asaj me subjektet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 51 të këtij ligji, ose me organizata ndërkombëtare, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;

d) uljen e qëndrimit në ajrim në ambiente të hapura deri në 2 orë, por jo më pak se 1 orë në ditë;

dh) përjashtimin nga organet përfaqësuese të të burgosurve.

Respektimi i të drejtave të parashikuara në këtë pikë për të burgosurit e vendosur në regjimin e posaçëm monitorohet nga Avokati i Popullit.

6. Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë është një vit dhe mund të zgjatet për periudha të tjera njëvjeçare. Zgjatja e këtij regjimi vendoset kur rezulton se ekzistojnë ende kushtet që i burgosuri mban lidhje me organizatën kriminale, grupin e strukturuar kriminal, bandën e armatosur apo organizatën terroriste. Për zgjatjen e këtij regjimi duhet mbajtur parasysh edhe profili kriminal i të burgosurit, roli që ai luan në organizatën kriminale, kohën që është angazhuar në këtë organizatë kriminale, ngritjen e akuzave të reja të pashqyrtuara më parë ndaj tij, sjelljen që ka mbajtur në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe nivelin e jetesës së anëtarëve të familjes. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e përfundimit të çdo periudhe njëvjeçare, Drejtuesi i Prokurorisë së



Posaçme mund t'i propozojë ministrit të Drejtësisë zgjatjen e këtij regjimi.

7. Ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, rivlerëson nëse janë kushtet për vazhdimin e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit. Në rastet kur ministri i Drejtësisë vendos mosmiratimin e zgjatjes së afatit të qëndrimit në regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve urdhëron dërgimin e të dënuarit në institucionin ku kryente dënimin ose të të paraburgosurit në institucionin ku qëndronte në paraburgim përpara vendosjes në regjimin e posaçëm.

8. Kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë për vendosjen ose zgjatjen e regjimit të posaçëm, i burgosuri, mbrojtësi ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të paraqesë kërkesë ankimore brenda 20 ditëve nga momenti i njoftimit të vendimit.

9. Kërkesa ankimore depozitohet në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila është kompetente për gjykimin e çështjes, sipas parashikimeve të nenit 471 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nuk pezullon vendimin e ministrit të Drejtësisë.

10. Në rastet kur kërkesa kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga gjykata, ministri i Drejtësisë vendos bazuar në vendimin e gjykatës.

Neni 18

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së zakonshme

1. Institucionet e sigurisë së zakonshme janë institucionet ku ekzekutohen dënimet ndaj të gjithë të dënuarve, me përjashtim të atyre që vendosen në institucionet e sigurisë së lartë, në institucionet e sigurisë së ulët dhe në institucionet e hapura.

2. Kur gjykata në vendimin me burgim nuk është shprehur për llojin e institucionit ku do të ekzekutohet dënimi, i dënuari vendoset në një institucion të sigurisë së zakonshme, duke ruajtur të drejtën e prokurorit sipas parashikimeve të nenit 16, pika 3, të këtij ligji.

3. Ndryshimi i klasifikimit të sigurisë së të dënuarve, që u ekzekutohet vendimi i dënimin në një institucion të sigurisë së zakonshme, kryhet nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të

Dënuarve, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji.

4. Kundër vendimit të komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve, i dënuari, përfaqësuesi i tij ligjor ose prokurori mund të paraqesë ankim në gjykatë brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Shqyrtimi i ankimit nga gjykata pezullon vendimin e komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve për ndryshimin e klasifikimit të sigurisë së të dënuarit.

Neni 19

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së ulët

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së ulët janë institucionet ku ekzekutohet dënimi për të dënuarit për kundërvajtje penale, për vepra penale nga pakujdesia dhe për vepra të tjera penale, dënimi i të cilave nuk i kalon pesë vjet burgim.

2. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos kalimin e të dënuarve nga një institucion i sigurisë së zakonshme në një institucion të sigurisë së ulët me kërkesë të drejtorit të institucionit ku ekzekutohet vendimi ndaj të dënuarit ose të përfaqësuesit të tij ligjor, në rast se i dënuari ka kryer jo më pak se 2/3 e dënimin.

Neni 20

Institucioni i hapur

1. Institucioni i hapur është institucioni ose seksioni ku ekzekutohen dënimet ndaj:

a) të dënuarit me burgim, të cilit i ka mbetur më pak se gjashtë muaj burgim për të vuajtur dhe kur raporti i komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve vlerëson se nuk përbën rrezik për sigurinë e institucionit apo të shoqërisë;

b) të dënuarit me gjysmëliri.

2. Transferimi në një institucion të hapur bëhet vetëm për të dënuarit me burgim, ekzekutimi i dënimin të të cilit bëhet në një institucion të sigurisë së ulët. Ky transferim miratohet nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve me kërkesë të drejtorit të institucionit ku ekzekutohet dënimi, të dënuarit ose të përfaqësuesit të tij ligjor.

3. Në rast se i dënuari shkel rregulloren e përgjithshme të burgjeve ose rregulloren e brendshme të institucionit, Komisioni i Vlerësimit



të Rrezikshmërisë së të Dënuarve, pas vlerësimit të rrethanave, mund të vendosë rikthimin e të dënuarit në një institucion të sigurisë së ulët.

Neni 21

Institucionet e paraburgimit

Institucionet e paraburgimit janë institucionet ku mbahen individët ndaj të cilëve gjykata ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”.

Neni 22

Vendosja e personave bashkëpunëtorë të drejtësisë

1. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale krijohen seksione të veçanta për vendosjen e personave të burgosur, që gëzojnë statusin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, merr masa për sigurimin e jetës së personit të burgosur, që gëzon statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe për realizimin e planit individual të trajtimit të tij.

Neni 23

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për gratë dhe të miturit

1. Të miturit e kryejnë dënimin në institucione për ekzekutimin e vendimeve penale për të mitur dhe, në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera, sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në këtë ligj.

2. I pandehuri i mitur, ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit “arrest me burg”, vendoset vetëm në seksionin për të mitur në mjediset e paraburgimit, ndërsa i mituri i dënuar me burgim vendoset në institucionin për ekzekutimin e vendimeve penale për të miturit.

3. I burgosuri i mitur vendoset veçmas nga i burgosuri i rritur. Ndalohej vendosja, mbajtja ose lëvizja e të miturit jashtë institucionit së bashku me një të burgosur të rritur. Përfshihet nga ky rregull, gjatë kryerjes së veprimtarive rehabilituese, arsimore, kulturore, sportive dhe veprimtarive të

tjera me natyrë kulturore dhe edukative të miturit mund të qëndrojnë bashkërisht, pavarësisht përkatësisë gjinore, ose bashkërisht me të rritur, por në çdo rast në prani të personelit të institucionit ku i mituri qëndron.

4. Të miturit që marrin pjesë në veprimtaritë e renditura në pikën 3 të këtij neni, shoqërohen dhe mbikëqyren në çdo rast nga personeli i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktivitetit përkatës.

5. Në mënyrë që të sigurohet mjedis i sigurt për të miturit në institucionin/seksionin për ta, të miturit ndahen në bazë të grup-moshës, llojit dhe rëndësisë së veprës penale, riskut të përsëritjes së veprës, zhvillimit fizik e mendor, si dhe karakteristikave të tjera, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të të miturit.

6. Të burgosurat e mitura vendosen veçmas nga të burgosurit e mitur.

7. Shërbimet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ku vendosen të miturit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e respektimit të shëndetit dhe dinjitetit të të miturit dhe në funksion të rishoqërizimit, riintegrit, rehabilitimit dhe parandalimit të rikryerjes së veprës penale ose të kryerjes së një veprë tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje. Për garantimin e interesit më të lartë të të miturit, institucioni përkatës duhet të ketë personel të mjaftueshëm, të specializuar dhe të trajnuar në vazhdimësi.

8. Të paraburgosurat gra ose vajza vendosen në dhoma ose seksione të veçanta nga meshkujt. Të dënuarat gra ose vajza e kryejnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për to në përputhje me këtë ligj.

9. Të dënuarave u lejohet të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç. Institucioni krijon mundësinë që e dënuara të jetojë me fëmijën në seksionin e posaçëm të grave me fëmijë. Për kujdesin dhe asistencën ndaj këtyre fëmijëve funksionojnë edhe çerdhe të posaçme. Vendimi për të larguar fëmijën nga nëna para moshës 3 vjeç mund të merret nga gjykata në rastet kur diktohet nga interesi më i lartë i fëmijës, bazuar në kërkesën e prindit tjetër, kujdestarit ligjor ose strukturave për mbrojtjen e fëmijëve.

10. Rregulla më të detajuara për mjediset e paraburgimit dhe ekzekutimit të dënimeve me burgim për të burgosurit e mitur dhe për të



burgosurat gra ose vajza përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 24

Vendet e caktuara të ekzekutimit të vendimeve penale

Ekzekutimi i vendimeve penale kryhet vetëm në vendet e caktuara posaçërisht sipas këtij ligji. Përgjithësisht, ministri i Drejtësisë, në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, të forcës madhore, kryerjes së punimeve të rëndësishme, si dhe kur rrezikohet jeta dhe shëndeti i të burgosurit, mund të urdhërojë që ekzekutimi i vendimeve penale të kryhet përkohësisht në vende të tjera të përshtatshme, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 25

Rregullorja e përgjithshme e burgjeve dhe rregulloret e brendshme të institucioneve

1. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e sistemit të burgjeve, disiplinën e brendshme dhe trajtimin e të burgosurve përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Çdo institucion ka rregulloren e brendshme, të miratuar në bazë të rregullores së përgjithshme të burgjeve. Rregullorja e institucionit përcakton organizimin, disiplinën e brendshme dhe rregullat e detajuara të trajtimit të të burgosurve në kushtet e institucionit.

3. Rregullorja e brendshme e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale hartohet nga komisioni i ngritur nga drejtori i institucionit dhe miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

KREU II

ORGANET DREJTUESE TË BURGJEVE

Neni 26

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe trajtimin e të burgosurve.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Drejtësisë.

3. Kandidati i propozuar për drejtor të Përgjithshëm të Burgjeve duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare ose diplomë ekuivalente me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë pune, nga të cilat të paktën 5 vjet në pozicione të nivelit të lartë drejtues;

ç) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale;

d) të mos ketë qenë i dënuar për një vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë më parë masa disiplinore e largimit nga detyra ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

4. Zëvendësdyrëtorët e Përgjithshëm të Burgjeve emërohen sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

5. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve civilë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

6. Marrëdhëniet e punës për punonjësit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve informon në mënyrë të vazhdueshme publikun për veprimtarinë e saj, në mënyrë që të kuptohet më mirë roli i sistemit të burgjeve në trajtimin e të burgosurve.

Neni 27

Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve

1. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe ka në përbërje të tij 5 anëtarë, një përfaqësues të shërbimit të sigurisë, një përfaqësues të sektorit ligjor, një përfaqësues të



sektorit të çështjeve shoqërore, një përfaqësues të shërbimit shëndetësor dhe specialisti i sektorit të kujdesit social, që trajton të dënuarin brenda institucionit.

2. Caktimi i 4 anëtarëve të komisionit, me përjashtim të specialistit të sektorit të kujdesit social, bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe ndryshon një herë në vit.

3. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos për ndryshimin e klasifikimit të sigurisë së të dënuarit dhe kalimin e tij nga një institucion i sigurisë së zakonshme në një institucion të sigurisë së ulët dhe anasjelltas. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos për kalimin e të dënuarit nga një institucion i sigurisë së ulët në një institucion të hapur dhe anasjelltas në përputhje me nenin 20 të këtij ligji.

4. Vlerësimi i rrezikshmërisë së të dënuarit mbështetet në kriteret e mëposhtme:

- a) analizën e faktorëve të riskut dhe mundësisë për përsëritjen e veprës penale;
- b) natyrën e veprës penale;
- c) rrezikun e arratisjes së të dënuarit;
- ç) rrezikun e kryerjes së një tjetre vepre penale nga i dënuari dhe ndikimin e saj në shoqëri;
- d) personalitetin, sjelljen e përgjithshme dhe analizën e sjelljes me të dënuarit e tjerë;
- dh) sjelljen kundrejt viktimës së veprës penale;
- e) faktin nëse është ose jo përsëritës;
- ë) nëse është përdorues ose ka krijuar varësi nga lëndët narkotike;
- f) nëse ka çrregullime të shëndetit mendor dhe si është trajtuar gjatë kryerjes së dënimit;
- g) nëse ka pasur përfitime të tjera gjatë kohës së kryerjes së dënimit;
- gj) si dhe çdo të dhënë tjetër, që vlerësohet e rëndësishme për menaxhimin, sigurinë dhe rendin e institucionit, dhe mirëqenien e sigurinë e të dënuarve të tjerë.

5. Komisioni interviston të dënuarin në çdo rast që shqyrton një kërkesë për ndryshimin e trajtimit të tij. Gjetjet e intervistës me të dënuarin bëhen pjesë e raportit të vlerësimit të rrezikshmërisë.

6. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve paraqet raport të vlerësimit të rrezikshmërisë mbështetur në raportin e vlerësimit të riskut të sigurisë, të hartuar nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku i dënuari

kryen dënimin, sa herë që gjykata e kërkon në bazë të pikës 4 të nenit 16 të këtij ligji.

7. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve paraqet raport të vlerësimit të rrezikshmërisë së të burgosurit në përputhje me nenin 68, pika 2, të këtij ligji.

8. Rregullat e posaçme për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 28

Instrumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë

1. Instrumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë dhe rregullat e zbatimit të tij përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

2. Instrumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë hartohet veçmas për të burgosurit e rritur dhe veçmas për të burgosurit e mitur.

3. Instrumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë për të burgosurit e mitur përgatitet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve merr mendimin e Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, të juridiksionit ku ka vendbanimin i mituri.

Neni 29

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë degë territoriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat janë përgjegjëse për pritjen, sistemimin, trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve.

2. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale drejtohen, mbikëqyren dhe përfaqësohen nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 30

Personeli i institucionit

1. Personeli i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale realizon zbatimin e planit individual të trajtimit të të burgosurve sipas detyrave të caktuara.



2. Personeli i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale vepron sipas standardeve më të larta profesionale dhe etiko-morale, duke mbajtur në konsideratë nevojat e çdo të burgosuri me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri.

3. Personeli i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale duhet të ruajë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tij, të sillet në mënyrë profesionale dhe me humanizëm, në përputhje me rregullat e etikës duke mbrojtur të drejtat dhe liritë e çdo të burgosuri.

4. Personeli që punon në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale ose seksione ku janë vendosur të burgosurit, të parashikuar në pikën 2, të nenit 14, të këtij ligji, duhet të jetë i specializuar në fushën përkatëse.

5. Institucioni përkatës i paraburgimit ose i ekzekutimit të vendimeve penale duhet të ketë personel të nevojshëm, të specializuar dhe të trajnuar në vazhdimësi për garantimin e të drejtave të të burgosurve, në funksion të riintegrit, rehabilitimit dhe parandalimit të rikryerjes së veprës penale ose të kryerjes së një veprë tjetër penale prej tyre.

6. Pranë institucioneve të paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur funksionon një grup shumëdisiplinor, i përbërë nga mjek, infermier, psikolog dhe punonjës social. Në këto institucione punësohet personel i mjaftueshëm psikologësh dhe punonjësish socialë, të specializuar dhe të trajnuar për këto mosha.

7. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale siguron mundësinë e trajtimit të të burgosurit nga mjeku specialist, sipas nevojave konkrete dhe sipas një regjimi kontrolli të mirëpërcaktuar.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kujdeset për të mundësuar trajnime dhe kualifikime të veçanta në fushat përkatëse.

9. Në punësimin e personelit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale mbahen parasysh, për aq sa është e mundur, sipas parashikimeve të këtij ligji, nevojat dhe veçoritë e të burgosurve në institucion, si dhe respektimi i barazisë gjinore.

Neni 31

Policia e Burgjeve

1. Policia e Burgjeve është përgjegjëse për:

a) ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si

dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve të të burgosurit në gjykata e institucione të tjera;

b) ruajtjen e personave të burgosur në institucionet e kujdesit shëndetësor publike e private;

c) sigurimin e jetës dhe të shëndetit të personave të burgosur; dhe

ç) garantimin e rendit dhe të sigurisë së institucionit në raste të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me legjislacionin në fuqi.

2. Organizimi dhe funksionimi i Policisë së Burgjeve rregullohet me ligj të veçantë.

KREU III

KUSHTET E JETESËS NË INSTITUCION

Neni 32

Ndërtesat

1. Godinat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale projektohen, ndërtohen, si dhe rikonstruktohen në mënyrë që të plotësojnë standardet për garantimin e sigurisë, kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare dhe të mundësojnë zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta të të burgosurve, zbatimin e planit individual të trajtimit të tyre dhe punësimin.

2. Rregullat dhe kriteret e detajuara për kushtet teknike, të sigurisë, të përshtatshmërisë dhe të aksesueshmërisë nga personat me aftësi të kufizuara, që duhet të plotësojnë ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33

Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes

1. Mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes respektojnë dinjitetin njerëzor dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit.

2. Kur nuk është e mundur të sigurohet fjetja në dhoma individuale, caktimi i të burgosurit në të njëjtën dhomë duhet të bëhet në mënyrë të tillë që



të shmangen konfliktet dhe ndikimet negative të ndërsjella. Për këtë qëllim përdoren kriteret e grup-moshave, të llojit të veprave penale të kryera dhe të veçorive intelektuale e psikike të të burgosurve dhe për atë që është e mundur edhe kërkesat e të burgosurve.

3. Për çdo të burgosur sigurohet shtrat i veçantë dhe komplet i përshtatshëm fjetjeje.

4. Në vendosjen e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe kushtet e mundësitë e të burgosurve, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar.

5. Standardet e dritave artificiale duhet të jenë të pranueshme, të ngjashme me standardet e ndriçimit artificial, që përdoret jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, dhe në përputhje me standardet teknike të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Të burgosurve u sigurohet energji elektrike e nevojshme për ndriçim dhe nevoja të higjienës personale.

Neni 34

Veshja dhe pajisjet

1. Çdo të burgosuri i sigurohet veshje dhe pajisje të tjera individuale në sasi të mjaftueshme për të siguruar plotësimin e kërkesave normale të jetesës dhe të përshtatshme me kushtet klimaterike.

2. Të burgosurit mund të autorizohen nga personeli i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale të mbajnë veshje dhe sende të përdorimit personal ose objekte që kanë një vlerë të veçantë morale ose personale. Rregullat e detajuara përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 35

Higjiena personale dhe e mjedisit

1. Të burgosurit i sigurohen mjediset dhe pajisjet e nevojshme për garantimin e higjienës personale.

2. Çdo institucion siguron shërbime periodike të mirëmbajtjes dhe pastrimit të mjediseve, të

veshmbathjes, të pajisjeve vetjake, si dhe të kujdesit personal. Vëmendje e veçantë u kushtohet të burgosurve me nevoja të veçanta shëndetësore, si dhe higjienës së të burgosurve gra dhe vajza. Çdo institucion siguron ujë të ngrohtë për higjienën vetjake të të burgosurve.

3. Përgjithësisht, për arsye të veçanta higjieno-sanitare, sigurimi i higjienës vetjake dhe kujdesit personal mund të ushtrohet në mënyrë të detyruar nga personeli i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale pas kërkesës së shërbimit mjekësor dhe me urdhër të drejtorit të institucionit.

4. Rregulla të detajuara për standardet higjieno-sanitare në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 36

Ushqimi

1. Të burgosurit i sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, natyrën e punës, kushtet klimaterike, besimin fetar dhe nevojat e veçanta të tij.

2. Të miturit të burgosur i sigurohet ushqimi në përputhje me moshën, gjendjen dhe nevojat e veçanta të tij, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

3. Të burgosurit që është i punësuar në punë të rënda, me sëmundje kronike, të burgosurës shtatzënë dhe të burgosurës që ka lindur fëmijë u sigurohet ushqimi sipas rekomandimit të mjekut.

4. Ushqimi i siguruar nga institucioni duhet të jetë i shumëllojshëm, i pasur me vlera ushqyese, të ndryshohet të paktën një herë në dy javë dhe t'u përshtatet kushteve klimaterike.

5. Ushqimi përgatitet dhe jepet si rregull në mjedise të caktuara për këtë qëllim. Me autorizim të drejtorit të institucionit, në raste të veçanta, të burgosurit mund të përgatisin dhe të konsumojnë ushqimin individualisht.

6. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të pranohen ushqime, të cilat sigurohen nga të burgosurit me shpenzimet e tyre tërësisht ose pjesërisht duke respektuar kërkesat e parashikuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

7. Të burgosurve duhet t'u sigurohet në vazhdimësi ujë i pijshëm.



8. Norma ushqimore ditore përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 37

Koha e ajrimit

1. Të burgosurit që nuk punojnë jashtë dhe të gjithë të burgosurit e tjerë, në ditët që nuk punohet, kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim në mjedise të hapura jo më pak se 2 orë në ditë, përveç rasteve të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji.

2. Përjashtimisht, për shkaqe të veçanta ose rrethana të jashtëzakonshme, kjo periudhë kohe mund të reduktohet, por jo më pak se 1 orë në ditë dhe vetëm me urdhër të arsyetuar të drejtorit të institucionit.

3. Ajrimi në mjedise të hapura bëhet në grupe, përveç rasteve të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji dhe në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 68, të këtij ligji.

4. Të burgosurit e mitur kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim jo më pak se 2 orë dhe të paktën 2 herë në ditë, përveç kohës për veprimtari social-edukative. Ajrimi për këtë kategori kryhet veçmas nga të rriturit dhe në përputhje me parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

5. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mundëson infrastrukturën e përshtatshme në rastet kur kushtet atmosferike janë jo të favorshme për kryerjen e ajrimit nga të burgosurit.

PJESA E TRETË PRANIMI DHE TRAJTIMI I TË DËNUARVE DHE TË PARABURGOSURVE NË INSTITUCION

KREU I PRANIMI

Neni 38

Pranimi në institucion

1. Në çdo institucion krijohet komisioni i pritjes për të pranuar të burgosurit e sapoardhur.

2. Komisioni i pritjes informon të burgosurin në një gjuhë të kuptueshme për të drejtat dhe detyrimet e tij, të drejtat e tij për këshillim e ndihmë juridike të garantuar nga shteti, për rregullat e

procedurat e paraqitjes së kërkesave dhe ankesave, rregulloren e institucionit. I burgosuri ka të drejtë të disponojë informacionin me shkrim.

3. Komisioni i pritjes përbëhet nga një përfaqësues i sektorit ligjor, një përfaqësues i sektorit të çështjeve shoqërore, një përfaqësues i shërbimit shëndetësor dhe një përfaqësues i shërbimit të sigurisë.

4. Të burgosurit e huaj, persona pa shtetësi ose që u përkasin pakicave kombëtare, u sigurohet informacioni i nevojshëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucion në formë verbale dhe të shkruar në gjuhën që e kuptojnë.

5. Të burgosurit me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar ndihmohen nga një interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit.

6. Menjëherë pas pranimi, drejtori i institucionit i krijon të burgosurit të huaj kushtet për të njoftuar familjen, mbrojtësin, kujdestarin ligjor, përfaqësuesin konsullor ose organizatën kompetente që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

7. Shtetasve të huaj, që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në Republikën e Shqipërisë, personave që gëzojnë statusin e refugjatit ose personave pa shtetësi u krijohen kushtet e komunikimit me përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbron interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar apo ndërkombëtar, detyra e të cilit është mbrojtja e interesave të këtyre personave.

8. Menjëherë pas pranimi në institucion, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen e gjendjes shëndetësore fizike dhe psikologjike, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e shenjave të dëmtimeve fizike, që janë shkaktuar jashtë institucionit në kohën e kontrollit.

9. Pranimi në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të të miturve të burgosur bëhet në përputhje me rregullat e kontrollit mjekësor dhe psikologjik të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

10. Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimi, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara. Nëse ka të dhëna dhe fakte që krijojnë bindjen e arsyeshme se ndaj tij mund të jetë kryer vepër penale, njoftohen organet



e procedimit penal në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

11. Mjeku, në rast se i kërkohet, duhet të pajisë të burgosurin e sapoardhur me një raport mjekësor, ku të shpjegohet gjendja e tij shëndetësore. Një kopje e këtij raporti bëhet pjesë e kartelës mjekësore të të burgosurit të sapoardhur dhe vihet në dispozicion të tij.

12. Në momentin e pranimit mbahet një inventar i sendeve personale të të burgosurit. Sendet që nuk mund të mbahen prej tyre, mbahen në kutinë e sigurisë dhe i burgosuri nënshkruan inventarin për to. Institucioni merr masat e nevojshme për të mbajtur dhe ruajtur sendet e të burgosurve.

13. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale vlerëson të dhënat individuale të të burgosurit për personalitetin e tij bazuar në dokumentacionin shoqërues, shpjegimet e dhëna prej tij, të dhënat e deklaruara në formularin e vlerësimit të riskut dhe raportit mjekësor të përgatitur sipas përcaktimeve të këtij neni.

14. Bazuar në të dhënat e përcaktuara në pikën 13 të këtij neni, hartohet regjistri i komisionit të pritjes dhe përgatitet plani individual i trajtimit për të burgosurin.

Neni 39

Organizimi i institucioneve për të burgosurit

1. Institucionet dhe seksionet e veçanta janë të organizuara sipas nevojave të trajtimit individual ose në grup të të burgosurve.

2. Përcaktimi i numrit të të burgosurve në institucione dhe në seksione, sistemimi dhe aktivizimi i tyre synon, për aq sa është e mundur, të favorizojë trajtimin e individualizuar.

3. Të burgosurit mund të marrin pjesë në veprimtari të veçanta të organizuara në institucione ose seksione të një kategorie të ndryshme nga ato ku janë caktuar, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji, ose kur i dënuari kryen dënimin në një institucion të sigurisë së lartë.

4. Vendosja e të burgosurit brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet duke pasur parasysh mundësinë që ai të përfitojë nga një trajtim i diferencuar në grup, në përputhje me kërkesat dhe angazhimin e tij.

5. Të burgosurit, si rregull, caktohen në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre, sipas dokumentacionit ligjor referues.

KREU II

DREJTIMET DHE FORMAT E TRAJTIMIT

Neni 40

Trajtimi

1. Trajtimi social-edukativ i të burgosurit zhvillohet me anë të aktiviteteve individuale dhe veprimtarive formuese. Trajtimi realizohet nga personeli i institucionit, që ka formimin e duhur në fushën përkatëse dhe aftësi profesionale në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të institucionit.

2. Komunikimi me anëtarët e familjes dhe personat e tjerë jashtë institucionit inkurajohet e sigurohet në përputhje me planin individual të trajtimit dhe programet e trajtimit, të rehabilitimit dhe riintegritimit, me përjashtim të rasteve kur zbatohet regjimi i posaçëm sipas nenit 17 të këtij ligji.

3. Trajtimi i të burgosurit bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme në përputhje me personalitetin e tij dhe nevojat e veçanta.

Neni 41

Shërbimet e kujdesit shëndetësor

1. Shërbimet e kujdesit shëndetësor sigurohen gjatë kohës së qëndrimit në institucion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe mbulohen nga siguri i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor, pavarësisht nga refuzimi i mundshëm i marrjes së shërbimit shëndetësor nga ana e të burgosurit.

2. Të burgosurit përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të legjislacionit në fuqi, dhe përfitojnë pa pagesë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor, sipas këtij ligji.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve. Organizimi dhe realizimi i kujdesit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit në bashkëpunim me qendrën spitalore të burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë.



4. I burgosuri i nënshtrohet të njëjtit trajtim dhe kujdes shëndetësor që zbatohen për shoqërinë në përgjithësi.

5. I burgosuri ka të drejtë të kryejë vizitat mjekësore nga një mjek dhe/ose në një institucion të kujdesit shëndetësor brenda vendit, me kushtin që t'i mbulojë vetë shpenzimet mjekësore dhe çdo shpenzim tjetër që rrjedh si pasojë e zgjedhjes së mjekut prej tij. Përrjashtimisht, të burgosurit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë mund të përfitojnë vizita mjekësore nga një mjek dhe/ose në një institucion të kujdesit shëndetësor të zgjedhur prej tyre vetëm pas vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarit. E drejta për të kryer vizita mjekësore nga një mjek dhe/ose në një spital të zgjedhur prej të burgosurve nuk zbatohet për të burgosurit e vendosur në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë, sipas parashikimit të nenit 17 të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur shërbimi i kërkuar nuk ofrohet nga shërbimi i kujdesit shëndetësor në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe qendra spitalore e burgjeve.

6. Shërbimet e kujdesit shëndetësor sigurojnë:

a) parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve;

b) furnizimin me barna dhe pajisje mjekësore në rastet e emergjencës shëndetësore kur ato nuk mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor;

c) profilaksinë për sëmundjet, duke bërë kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe ato ngjitëse;

ç) sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të paraburgosurve dhe të dënuarve.

7. Çdo institucion ka shërbim shëndetësor e farmaceutik, që u përgjigjet nevojave për parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit të të burgosurve.

8. I burgosuri që dyshohet ose ka sëmundje ngjitëse, izolohet menjëherë në mjedise të posaçme dhe trajtohet sipas standardeve të njëjta me personat e të njëjtës kategori jashtë institucionit.

9. Në institucionet ku ekzekutohet dënimi me burgim për gratë dhe vajzat, funksionojnë shërbimet e specializuara në shërbim të grave shtatzëna dhe atyre me fëmijë në gj.

10. Personeli mjekësor viziton çdo ditë të burgosurin e sëmurë, që bën kërkesë me shkrim ose verbale drejtuar stafit shëndetësor ose personelit të sigurisë në regjim, dhe kontrollojnë

periodikisht të gjithë të burgosurit e tjerë sipas një grafiku të hartuar nga drejtoria e institucionit.

11. Personeli mjekësor evidenton dhe njofton menjëherë për sëmundjet që kërkojnë trajtim të specializuar.

12. Për rastet e sëmundjeve ngjitëse ose të sëmundjeve të tjera, diagnostikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të sigurohen në kushtet e institucionit, i burgosuri transferohet në qendrën spitalore të burgjeve dhe, kur është e nevojshme, transferohet në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë ose në institucionet spitalore rajonale në varësi të saj.

13. Diagnostikimi dhe mjekimi pranë Qendrës Spitalore Universitare dhe institucioneve spitalore rajonale bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

14. Në raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të burgosurit, ai transferohet për mjekim në qendrën spitalore të burgjeve ose në institucionet e kujdesit shëndetësor rajonal.

15. Struktura shtetërore përgjegjëse për inspektimin shëndetësor, si dhe çdo institucion varësie i tij inspektojnë, të paktën dy herë në vit, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale gjenden higjieno-sanitare të mjediseve dhe masat e marra nga shërbimi shëndetësor i institucionit për parandalimin e sëmundjeve infektive.

16. Ndalohen eksperimentet shëndetësore që përfshijnë të burgosurit dhe që mund të shkaktojnë dëmtime fizike, çrregullime mendore ose dëmtime të tjera.

17. Rregullat e detajuara për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shëndetësore për personat e burgosur përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit të Drejtësisë.

Neni 42

Shërbimet e kujdesit shëndetësor për kategori të veçanta

1. Shërbimi i kujdesit shëndetësor në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale i garantohet çdo të burgosuri pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi.



2. Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor sigurohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor. I burgosuri që gjendet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që ka çrregullime të shëndetit mendor gëzon të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë strukturave shëndetësore të specializuara për trajtimin e sëmundjeve të shëndetit mendor ose në qendrën spitalore të burgjeve, sipas rastit.

3. Trajtimi shëndetësor i të burgosurve përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor duke përfshirë, por pa u kufizuar në kontrollet për:

- a) sëmundjet seksualisht të transmetueshme;
- b) sëmundjet e lindura të gjakut;
- c) kujdesin shëndetësor mendor;
- ç) çrregullimet posttraumatike;
- d) rrezikun e vetëvrasjes ose të vetëdëmtimit;
- dh) historinë e shëndetit riprodhues;
- e) praninë e varësisë të drogës;
- ë) abuzimin seksual dhe format e tjera të dhunës, që mund të ketë pësuar përpara pranimin në institucion.

4. Të miturve të burgosur u sigurohet kujdesi dhe trajtimi mjekësor në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

5. Grave dhe të miturave të burgosura u ofrohen programe dhe shërbime specifike në përputhje me moshën dhe gjininë e tyre. Ato informohen me një gjuhë të kuptueshme për kujdesin shëndetësor, për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, për higjienën vetjake, për format e dhunës dhe për çdo lloj abuzimi. Gratë dhe të miturat, që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike e seksuale u nënshtrohen programeve të kujdesit shëndetësor për trajtimin dhe rehabilitimin e tyre.

6. Në rastin e grave të burgosura, institucioni siguron kontrollin periodik nga mjeku gjinekolog, mjeku psikiatër dhe kontrole periodike për parandalimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve të kancerit të gjirit dhe sëmundjeve të tjera për gratë.

Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për gratë sigurohen kushtet e nevojshme dhe të veçanta për kujdesin dhe trajtimin e gruas shtatzënë, para lindjes dhe pas lindjes. Lindja e fëmijës realizohet në një institucion shëndetësor jashtë sistemit të burgjeve. Nëse një fëmijë ka

lindur gjatë kohës që nëna kryen dënimin, ky fakt nuk përmendet në certifikatën e lindjes.

7. Të burgosurit që shfaqin shenja të përdorimit të drogës, të substancave psikotrope, alkoolit ose shfaqin shenja të stresit u nënshtrohen të njëjtave programe shëndetësore dhe sociale që zbatohen jashtë institucionit.

8. Personat që mbartin sëmundje infektive, përfshirë virusin HIV, trajtohen në përputhje me standardet që zbatohen për këto kategori në institucionet spitalore.

9. Të burgosurit me sëmundje kronike ose të moshuar përfitojnë shërbime të kujdesit shëndetësor sipas standardeve që zbatohen për këto kategori pranë institucioneve të specializuara jashtë sistemit të burgjeve.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve garanton ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor të nevojshëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe, në rast se ofrimi i këtyre shërbimeve është i pamundur të kryhet në këto institucione, shërbimet mundësohen në struktura shëndetësore të specializuara jashtë sistemit të burgjeve.

11. Për qëllime të zbatimit të pikës 2 të këtij neni, Ministria e Drejtësisë dhe ministria përgjegjëse për shëndetësinë nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët bashkëpunimi.

Neni 43

Punësimi

1. I burgosuri i aftë për punë ka të drejtë të kryejë një punë të denjë dhe të zgjedhur prej tij. Ndalohej puna e detyruar ose si formë e dënimit disiplinor.

2. Puna e kryer nga i burgosuri shpërblehet dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni.

3. Punësimi i të burgosurit ka si qëllim të garantojë fitimin, ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive për punë dhe njohurive profesionale, për riintegrimin në shoqëri pas përfundimit të kryerjes së dënimit.

4. Përshtetimi i përgjithshëm i punës që kryhet nga i burgosuri duhet të jetë në përputhje me gjendjen shëndetësore, njohuritë dhe aftësitë për punë, formimin profesional, karakteristikat e veçanta të personalitetit, si dhe me perspektivën e riintegrit të tij në shoqëri.



5. I burgosuri punësohet nga administrata e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose nga persona juridikë privatë brenda ose jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Ndalohet punësimi jashtë institucionit i të burgosurit, që është vendosur në institucionet e sigurisë së lartë. Kontrata e punësimit e lidhur me një të burgosur nuk duhet të tregojë se ai ose ajo është duke kryer dënimin.

6. Personeli i institucionit nxit dhe krijon kushte për vetëpunësimin e të dënuarve.

7. Të burgosurit me aftësi të kufizuara mund të punësohen duke i ofruar një përshtatje të arsyeshme sipas llojit të punës ose duke e përdorur punën për qëllime terapeutike.

8. Punësimi jashtë institucionit i të dënuarve mund të lejohet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve me propozimin e drejtorit të institucionit në rastet kur nuk cenohen nevojat e sigurisë dhe e lejon vlerësimi i rrezikshmërisë së të dënuarit.

9. Rregullat e detajuara për ruajtjen dhe sigurinë e të burgosurve, që punësohen jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimit të vendimeve penale, përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

10. I burgosuri i mitur mund të punësohet vetëm nëse një gjë e tillë lehtëson edukimin profesional, punësimin e tij pas lirimit dhe nuk pengon arsimimin e tij. Angazhimi i të miturve në punë të lehta kryhet në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në Kodin Punës.

11. Punësimi i të paraburgosurve jashtë institucionit mund të lejohet vetëm me vendim të prokurorit. Në çdo rast, dalja jashtë institucionit dhe kryerja e punës realizohen gjithmonë të shoqëruar nga personeli i institucionit dhe të ruajtur nga Policia e Burgjeve.

12. Rregullat e posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës dhe kohëzgjatja e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 44

Shpërblimi i punës

1. I burgosuri ka të drejtën e një shpërblimi mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe

organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. I burgosuri ka të drejtë të disponojë lirshëm dyzet për qind të të ardhurave të fituara nga puna.

Neni 45

Arsimimi

1. Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhen me anë të organizimit të programeve arsimore, si dhe të kurseve profesionale, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar dhe legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.

2. Të burgosurit që nuk ka përfunduar arsimin nëntëvjeçar i krijohen kushte për përfundimin e tij me anë të një programi të veçantë, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.

3. I burgosuri ka të drejtë të vazhdojë arsimin e mesëm dhe të lartë gjatë kohës së qëndrimit në institucion, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionit për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë.

4. Për atë që është e mundur, arsimimi i të burgosurit integrohet me sistemin arsimor dhe sistemin e trajnimit profesional për të lehtësuar vijimin e arsimimit dhe trajnimit profesional pa vështirësi pas përfundimit të kryerjes së dënimin. Arsimi dhe trajnimi profesional i të burgosurit zhvillohet nën vëzhgimin e institucioneve të jashtme arsimore dhe të formimit profesional.

5. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale nxisin përfitimin, njohjen dhe certifikimin e kualifikimeve profesionale, si dhe kryerjen dhe lehtësimin e ndjekjes së kurseve profesionale duke përdorur kurset me kohë të pjesshme.

6. Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të të burgosurit me moshë nën 29 vjeç.

7. Të burgosurve të mitur dhe të rinj u sigurohet arsimi bazë i detyrueshëm dhe, sipas rastit, edhe arsimi i mesëm ose i lartë. Organizimi i programeve arsimore dhe edukuese për të burgosurit e mitur dhe të rinj kryhet në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

8. Të burgosurit që u përkasin pakicave kombëtare, që nuk kuptojnë ose nuk zotërojnë gjuhën shqipe, shtetasve të huaj ose personave pa



shtetësi, që nuk kuptojnë gjuhën shqipe, u mundësohen materiale të shkruara në gjuhën e tyre ose në një gjuhë që e kuptojnë më mirë.

9. Rregullat më të detajuara për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

Neni 46

Veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive

1. Organizimi i veprimtarive kulturore, çlodhëse e sportive duhet të synojë ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive fizike dhe psikike të të burgosurit.

2. Për të burgosurit e mitur hartohet një program i veçantë përfshirjeje në veprimtari kulturore, krijuese e sportive, në bashkëpunim me të miturin.

3. Të burgosurit me aftësitë kufizuara i sigurohen programe trajnuese ripërtëritëse, çlodhëse, kulturore e sportive, që sigurojnë përshtatjen e arsyeshme.

4. Institucioni bashkëpunon me institucionet e tjera, organizatat jofitimprurëse e fetare për organizimin e veprimtarive kulturore, krijuese dhe sportive, brenda dhe jashtë institucionit.

Neni 47

Mjediset dhe kushtet e trajtimit

1. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në varësi të nevojave të trajtimit, sigurohen mjedise, kushte të përshtatshme dhe të nevojshme për zhvillimin e punës, arsimimin parauniversitar dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër e përbashkët ose individuale.

2. Pranë çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale krijohet biblioteka me botime bashkëkohore dhe periodike. Në institucionet për të mitur, botimet dhe periodikët mbajnë parasysh nevojat e të burgosurit të mitur.

Neni 48

Lidhjet me familjen

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i kushtojnë kujdes të veçantë ruajtjes,

përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të burgosurit me familjen.

2. I burgosuri ka të drejtë të informojë menjëherë anëtarët e familjes për futjen e tij në institucion ose kur transferohet prej tij. Me pëlqim të të burgosurit, komunikimi mund të bëhet edhe nga personeli i institucionit.

3. Të burgosurit të mitur i garantohen kontaktet me anëtarët e familjes dhe rrethin shoqëror sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

4. Institucioni njofton menjëherë anëtarët e familjes në rast vdekjeje, sëmundjeje të rëndë fizike ose psikike, plagosje të rëndë të një të burgosuri ose transferimin e tij në qendrën spitalore të burgjeve.

5. Institucioni njofton menjëherë të burgosurin kur vihet në dijeni për vdekjen ose sëmundjet e rënda të anëtarëve të familjes së tij.

6. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale harton një program të individualizuar për të favorizuar lidhjet e të burgosurit me anëtarët e familjes në varësi të nevojave që kanë të burgosurit e mitur dhe të burgosurat që kanë fëmijë të mitur.

Neni 49

Takimet, vizitat, korrespondencat dhe informacioni

1. I burgosuri ka të drejtën e vizitës të paktën katër herë në muaj me anëtarët e familjes me kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Kur organizimi i institucionit e lejon, i burgosuri mund të autorizohet të qëndrojë me familjarët përtej kufirit kohor të parashikuar. Vizitat zhvillohen në mjedise të veçanta nën mbikëqyrjen e personelit të institucionit, jo të dëgjimit, sipas rregullave të parashikuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Në rastin e të paraburgosurve merret miratimi paraprak me shkrim i prokurorit.

2. Për vizitat që u bëhen grave të burgosura nga fëmijët e tyre zbatohen rregulla të posaçme dhe u mundësohen vizita më të shpeshta.

3. Të burgosurit kanë të drejtë të komunikojnë me median, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe të arsyeshme që përlligjin moslejimin e këtyre kontakteve të lidhura me: ruajtjen e sigurisë brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, me integritetin e viktimave, të burgosurve të tjerë ose të personelit të institucionit.



4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, bazuar në kërkesën e motivuar, autorizon hyrjen e medieve në mjediset e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për autorizim mbahen parasysh të gjitha aspektet e sigurisë të parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Në rastin e të paraburgosurve, merret miratimi paraprak me shkrim i prokurorit.

5. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mundëson takime konfidenciale të të burgosurve me personat e parashikuar sipas nenit 51 të këtij ligji: anëtarët e komisionit të ekzekutimit të vendimeve penale, komisionerët e krijuar me ligj të posaçëm, përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike të garantuar nga shteti, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të të drejtave të fëmijëve, grave, të rinjve, me të cilët Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

6. Në rastin e të burgosurve të mitur, korrespondenca telefonike dhe takimet me anëtarët e familjes realizohen në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

7. Personeli i institucionit vë në dispozicion të të burgosurit mjetet e nevojshme për realizimin e korrespondencës. Për të burgosurit që nuk kanë mundësi financiare, personeli i institucionit mundëson kartë me impulse ose siguron takime *online* nga institucioni.

8. Institucioni siguron krijimin e mjediseve të përshtatshme për qëndrimin e të dënuarit me familjen. Kjo e drejtë mundësohet pa diskriminim mbi bazë gjinie dhe sigurisë së institucionit, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji.

9. Të burgosurit i lejohet kryerja e bisedave telefonike me anëtarët e familjes, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrjen vizuale të personelit të institucionit. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose gjykatës, kufizon të drejtën e të paraburgosurit ose të të dënuarit për biseda telefonike.

10. Të burgosurit lejohen të mbajnë gazeta, revista e libra, që janë në shitje të lirë dhe të shfrytëzojnë mjete të tjera informacioni.

11. Kontrolli i korrespondencës së të burgosurit bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

12. Nuk lejohet kontrolli i korrespondencës me Avokatin e Popullit, mbrojtësit dhe organizmat ndërkombëtarë kompetentë në fushën e të drejtave të njeriut.

13. Përjashtimisht për të burgosurin ndaj të cilit zbatohet regjimi i posaçëm, të drejtat e parashikuara në këtë nen zbatohen për atë që nuk bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të këtij ligji.

14. Rregulla të detajuara, për kryerjen e vizitave, takimeve dhe mbajtjes së korrespondencës përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 50

E drejta e besimit dhe ushtrimi i riteve fetare

1. Të burgosurit kanë të drejtën e besimit dhe të ushtrimit të riteve. Institucioni siguron mjedise të veçanta për të lejuar praktikimin e fesë dhe ndjekjen e besimit fetar nga të burgosurit.

2. Të burgosurit kanë të drejtë të takohen me përfaqësues të komuniteteve fetare, të caktuar në marrëveshje ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe komuniteteve fetare të njohura ligjërisht dhe të mbajnë libra që lidhen me fenë ose besimin.

Neni 51

Hyrja në institucion

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të vizitohen pa autorizim nga: Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, zëvendëskryetari i Kuvendit, zëvendëskryeministri, ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, deputetët, zëvendësministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësit e tij, drejtori i Policisë së Burgjeve, drejtori dhe inspektorët e kontrollit të brendshëm të burgjeve, anëtarët e komisionit të ekzekutimit të vendimeve penale, gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të



detyrës së tyre, mbrojtësit e të burgosurve, si dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të deleguar.

2. Personat që shoqërojnë subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, nuk pajisen me autorizim në rastin e vizitave pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, por në çdo rast numri i tyre nuk duhet të jetë më shumë se dy.

3. Mbrojtësit e të burgosurit mund të shoqërohen vetëm nga kandidatët për avokat që kryejnë stazhin pranë tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.

4. Të drejtën të hyjnë pa autorizim në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale e kanë edhe përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare, në kuadër të angazhimeve të marra përsipër nga Republika e Shqipërisë, gjatë kryerjes së vizitave monitoruese.

5. Personat e autorizuar në urdhrin e inspektimit nga ministri i Drejtësisë, gëzojnë të drejtën të hyjnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

6. Personat e tjerë, që nuk parashikohen në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, mund të hyjnë në institucion vetëm me autorizim të drejtorit të institucionit.

7. Personat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, kanë të drejtë të ankohen pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në rast refuzimi pa shkaqe të arsyeshme të dhënies së autorizimit nga drejtori i institucionit.

8. Rregullat e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe për përfaqësuesit e komuniteteve fetare.

PJESA E KATËRT REGJIMI NË INSTITUCION

KREU I NORMAT E SJELLJES, ZHDËMTIMI DHE PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 52

Normat e sjelljes në institucion

1. Rregullorja e përgjithshme e burgjeve dhe rregullorja e brendshme e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale përcaktojnë rregulla për trajtimin, regjimin dhe sjelljen e të burgosurve në institucion, në përputhje me

parashikimet e këtij ligji, dhe me synim rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve.

2. Personeli i institucionit që në momentin e pranimit në institucion, e njëh të burgosurin me të drejtat e detyrat e tij, rregullat e trajtimit dhe të disiplinës dhe rregulloren e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Gjatë kohës së qëndrimit në institucion, i burgosuri është i detyruar të respektojë rregullat e parashikuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

3. Asnjë të burgosuri nuk mund t'i caktohet detyra në shërbimet e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, që i japin atij një pozicion më të favorshëm në krahasim me të burgosurit e tjerë.

Neni 53

Përgjegjësia për dëmet

1. I burgosuri duhet të kujdeset për sendet e vëna në dispozicion të tij, si dhe të shmangë çdo dëmtim të sendeve të të tjerëve.

2. I burgosuri që shkakton dëm material ndaj personelit të institucionit ose personave të tjerë, detyrohet të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar.

3. Rregulla të hollësishme për mënyrën dhe kriteret e shpërblimit të dëmit përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 54

Kontrolli personal i të burgosurit

1. I burgosuri i nënshtrohet kontrollit personal në çdo rast të hyrjes ose të daljes nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale dhe në rastet kur ka dyshime të arsyeshme që mban sende të ndaluara.

2. Kontrolli personal i të burgosurit duhet të jetë në proporcion me nevojën që dikton kryerjen e tij dhe bëhet duke respektuar dinjitetin, besimin dhe veçori të tjera të tij.

3. Kontrolli mund të bëhet vetëm nga persona me të njëjtin gjini me të burgosurin, në praninë e jo më pak se dy punonjësve, në mënyrë që të shmangë mundësinë e kontaktit vizual nga personeli i gjinisë tjetër.

4. Kontrolli i të burgosurave gra dhe vajza kryhet vetëm nga stafi me të njëjtën gjini, i trajnuar me metoda të përshtatshme kontrolli, në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.



5. Kontrolli i të miturit të burgosur kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit.

6. Në çdo rast, ndalohet kontrolli intim ndaj të burgosurit nga punonjësi i Policisë së Burgjeve. Kontrolli intim bëhet vetëm nga mjeku i institucionit, me autorizim të drejtorit të institucionit vetëm kur ka dyshim të arsyeshëm se personi që kontrollohet mund të ketë fshehur sende të ndalura. Kontrolli intim bëhet në përputhje me rregullat dhe sipas procedurës së parashikuar në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 55

Kontrolli në mjediset e dhomave

Kontrolli në mjediset dhe dhomat ku qëndrojnë të burgosurit kryhet nga personeli i specializuar në prani të të burgosurit, me përjashtim të rasteve kur prania e tij përbën rrezik për sigurinë fizike të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 56

Kontrolli personal i vizitorëve dhe i personelit

Kontrolli personal zbatohet edhe për subjektet që kanë statusin e vizitorit dhe për personelin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 57

Shoqërimi i të burgosurit

1. Lëvizjet e burgosurit jashtë institucionit bëhen për aq sa është e mundur brenda një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast nën shoqërimin e personelit të Policisë së Burgjeve, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

2. Shoqërimi i grave dhe i të miturave të burgosura kryhet nga personeli i së njëjtës gjini, ndërsa shoqërimi i të burgosurve të sëmurë kryhet me praninë e stafit mjekësor.

3. Gjatë lëvizjes tregohet kujdesi i duhur për ta ekspozuar të burgosurin sa më pak që të jetë e mundur para publikut, duke marrë masat e duhura mbrojtëse për të siguruar mbrojtjen e identitetit tij

dhe të kushteve, që nuk cenojnë dinjitetin apo përkeqësojnë gjendjen e tij fizike.

4. Në lëvizjet në grup është i detyrueshëm përdorimi i prangave ose i mjeteve të tjera shtrënguese. Mjetet shtrënguese që përdoren gjatë lëvizjes së të burgosurit duhet të jenë në proporcion me nivelin e rrezikut dhe qëllimin për të cilin përdoren.

Neni 58

Kërkesa dhe ankesa

1. I burgosuri ka të drejtë të paraqesë kërkesë ose ankesë drejtuar personelit të institucionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare, organizatave jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, prokurorit ose gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, si dhe personave që sipas nenit 51 të këtij ligji kanë të drejtë të vizitojnë institucionin.

2. Kërkesa paraqitet me shkrim ose, përjashtimisht, në mënyrë verbale. Ankesa e paraqitur verbalisht dhe që i drejtohet personelit të institucionit, nëse kërkohet nga burgosuri, dokumentohet me procesverbal.

3. I burgosuri informohet për mundësinë e takimeve me drejtorin e institucionit ose personelin përgjegjës për çështje në interes të tij ose që përbëjnë shqetësim.

4. Personeli i institucionit ndihmon të burgosurin të mbajë kontakte me botën e jashtme dhe vë në dispozicion të tij mjetet e nevojshme për përgatitjen e kërkesës ose ankesës.

5. Personeli i autorizuar organizon takime periodike me të burgosurit, me qëllim krijimin e mundësive të paraqitjes së kërkesave ose ankesave. Rregullat dhe procedurat për shpeshtësinë, kohën e takimeve dhe mënyrën e zhvillimit të tyre përcaktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

6. Kërkesa ose ankesa, pasi regjistrohet në një regjistër të veçantë, i dorëzohet drejtorit të institucionit, i cili ngarkon punonjësën përkatëse për trajtimin e saj dhe kthimin e përgjigjes të burgosurit.

7. Bazuar në ankesën e paraqitur nga i burgosuri, drejtuesi i institucionit mund të kërkojë fillimin e një procedurë inspektimi ose të paraqesë



kallëzim penal kur konstaton se ka elemente të veprës penale.

8. Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose të ankesave të të burgosurve në formë shkresore dhe elektronike. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit, si dhe procedura për kthimin e përgjigjes përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 59

Afatet e shqyrtimit të ankesës dhe të kërkesës

1. Organet kompetente, sipas këtij ligji, shqyrtojnë ankesën dhe kërkesën sa më parë, por jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja, përveç rasteve kur ky ligj parashikon afate të posaçme për shqyrtimin e tyre.

2. Kundër vendimit të dhënë sipas pikës 1 të këtij neni, ose në rastin kur organet kompetente nuk shprehen me vendim, i burgosuri ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve brenda 30 ditëve nga marrja dijeni. Kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i burgosuri ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente sipas parashikimeve të nenit 80 të këtij ligji.

3. I burgosuri ka të drejtë të paraqesë kërkesa dhe ankesa pranë Komisionit Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Rregullat, procedurat dhe afatet e shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave nga Komisioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.

Neni 60

Rregullat e disiplinës

1. Rregullat e disiplinës zbatohen në mënyrë që të stimulojnë ndjenjën e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të të burgosurit. Ato hartohen në përshtatje me gjininë, moshën, gjendjen fizike, psikike e psikologjike të tij.

2. Për të burgosurit e mitur, të burgosurit e diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, të burgosurit që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose të abuzimit seksual, zbatohet një regjim disiplinor lehtësues në përputhje me nevojat e tyre.

3. Rregullat e regjimit disiplinor lehtësues dhe procedurat për zbatimin e tij përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 61

Rregullat e zbatimit të masave disiplinore

1. Masat disiplinore duhet të jenë forma e fundit e rregullimit të sjelljes. Në rastet kur është e mundur, personeli i institucionit përdor ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet të burgosurve ose mes tyre dhe personelit të institucionit.

2. Ndaj të burgosurve nuk mund të merren masa disiplinore për një fakt që nuk është parashikuar shprehimisht si shkelje në këtë ligj.

3. Masa disiplinore mund të jepet vetëm pasi është respektuar e drejta e të burgosurit për t'u dëgjuar dhe verifikimit të pretendimeve të parashtruara prej tij.

4. Masat disiplinore caktohen në përputhje me llojin dhe rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të burgosurit ndaj saj, moshën, personalitetin e tij, si dhe gjendjen fizike ose psikologjike të të burgosurit.

5. Në rastin e të burgosurve të mitur, llojet e masave disiplinore dhe kufijtë e zbatimit të tyre jepen në përputhje me parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

6. Masat disiplinore zbatohen në mënyrë të tillë, që të nxisin ndjenjën e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të të burgosurit.

7. Ndalohen dënimet kolektive, ndëshkimet trupore, dënimi përmes vendosjes në dhoma të errëta dhe forma të tjera dënimesh degraduese ose poshtëruese.

Neni 62

Klasifikimi i shkeljeve disiplinore

1. Shkeljet disiplinore klasifikohen në:

- a) shkelje të lehta;
- b) shkelje të rënda;
- c) shkelje shumë të rënda.

2. Shkelje të lehta disiplinore janë:

- a) neglizhenca në kryerjen e pastrimit personal, të dhomës ose të mjediseve të përbashkëta;
- b) simulimi i sëmundjes.

3. Shkelje të rënda disiplinore janë:



a) përdorimi i fjalëve të pahijshme dhe fyese ndaj të burgosurve të tjerë ose personelit të institucionit;

b) kryerja e veprimeve ose akteve me qëllime përfitimi;

c) moszbatimi i urdhrave të personelit të institucionit ose vonesa e pajustificuar në zbatimin e tyre.

4. Shkelje shumë të rënda disiplinore janë:

a) organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e veprimtarive, që cenojnë masat e sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;

b) kundërshtimi me dhunë i punonjësve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale;

c) ushtrimi i dhunës fizike ose psikike ndaj të burgosurve të tjerë;

ç) përgatitja dhe përpjekja për t'u larguar nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ose gjatë shoqërimit të të burgosurit;

d) përvetësimi ose dëmtimi me dashje i pasurisë së institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të burgosurve të tjerë;

dh) dhuna verbale ose sjellja agresive ndaj të burgosurve të tjerë;

e) mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur nuk përbën vepër penale;

ë) përdorimi i lëndëve narkotike dhe pijeve alkoolike;

f) shkelja e afatit të kthimit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale pas lejes, pa arsye objektive të vërtetuara.

5. Ndaj të burgosurve nuk mund të fillojë procedimi disiplinor në rastet kur sjelljet, veprimet ose mosveprimet e tyre nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

Neni 63

Masat parandaluese

1. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të urdhërojë veçimin e të burgosurit vetëm për shkelje shumë të rënda disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 62 të këtij ligji, duke e vendosur në mjediset e veçimit deri në mbledhjen e komisionit disiplinor. Këto mjedise duhet të respektojnë standardet minimale që zbatohen për qëndrimin e të dënuarve.

2. Masa parandaluese ka si qëllim garantimin e sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe parandalimin e dëmtimeve ose pasojave

që mund të vijnë nga sjellja ose veprimet e të burgosurit.

3. Masa parandaluese vendosen pa diskriminim dhe duhet të jenë në proporcion me situatën dhe nivelin e rrezikut.

Neni 64

Masat disiplinore

1. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa:

a) këshillim individual;

b) përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë;

c) përjashtim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë;

ç) përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë.

2. Ndalohet dënimi dy herë i të burgosurve për të njëjtën shkelje për të cilën është shprehur më parë me vendim organi kompetent disiplinor.

3. I burgosuri ndaj të cilit është dhënë një masë disiplinore, në përputhje me shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, vendoset në dhomat e veçimit, të cilat duhet të respektojnë standardet minimale që zbatohen për qëndrimin e të dënuarve, deri në përfundim të kohëzgjatjes së masës disiplinore.

4. Masat e parashikuara në shkronjat “b”, “ç” dhe “ç”, të pikës 1, jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar në rastet e të burgosurave gra. Ndaj të burgosurave shtatzëna ose që kanë fëmijën nën përkujdesje në institucion zbatohet vetëm masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni.

5. Ndaj të burgosurve me aftësi ndryshe fizike ose çrregullime të shëndetit mendor masat disiplinore, të parashikuara në shkronjat “b” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të jepen nëse ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes së tyre, bazuar në raportin mjekësor të hartuar në përputhje me nenin 65, pika 4, të këtij ligji.

6. Masat disiplinore të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta, të parashikuara në shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, nuk mund fillojnë të zbatohen pa pasur një raport paraprak të lëshuar nga mjeku, që vërteton gjendjen fizike dhe mendore të të burgosurit.

7. Zbatimi i masës disiplinore të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta i nënshtrohet kontrollit të përditshëm mjekësor. Gjatë zbatimit të kësaj mase disiplinore duhet t'i garantohet të



paktën një herë kontakte me anëtarët e familjes dhe të paktën një orë ajrim çdo ditë nëse e lejojnë kushtet atmosferike.

8. Masat disiplinore, llojet dhe kufijtë e zbatimit të tyre ndaj të burgosurve të mitur parashikohen në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Rregullat e posaçme për zbatimin e tyre parashikohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

9. Masat disiplinore administrohen në dosjen personale të të dënuarit.

Neni 65

Organi kompetent për dhënien e masave disiplinore

1. Masa disiplinore e këshillimit individual jepet nga drejtori i institucionit.

2. Masat disiplinore të parashikuara nga shkronjat “b”, “c”, “ç” të nenit 64 të këtij ligji vendosen nga komisioni disiplinor. Komisioni disiplinor përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

- a) drejtori i institucionit, në cilësinë e kryetarit;
- b) përgjegjësi i sektorit ligjor;
- c) përgjegjësi i sektorit të sigurisë;
- ç) përgjegjësi i sektorit të kujdesit social; dhe
- d) specialisti i sektorit të kujdesit social që trajton të dënuarin.

3. Komisioni disiplinor ngrihet dhe funksionon me urdhër të drejtorit të institucionit, i cili mbledh komisionin disiplinor jo më vonë se 48 orë nga momenti i konstatimit të shkeljes.

4. Përpara fillimit të shqyrtimit disiplinor, mjeku përgatit një raport mjekësor ku shprehet për gjendjen shëndetësore të të burgosurit ndaj të cilit ka filluar procedura disiplinore. Raporti vihet në dispozicion të komisionit disiplinor dhe shqyrtohet prej tij për efekt të përcaktimit të masës disiplinore. Mjeku merr pjesë në mbledhjet e komisionit disiplinor pa të drejtë vote dhe ka të drejtë të japë sqarime nëse kjo kërkohet nga komisioni disiplinor.

Neni 66

Procedura e dhënies së masave disiplinore

1. Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore pasi ka dëgjuar më parë të burgosurin ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor.

2. Institucioni merr masa për njoftimin e fillimit të procedimit disiplinor. Njoftimi i personit të

interesuar ose refuzimi i tij për t'u shprehur përpara komisionit disiplinor vërtetohet kundrejt nënshkrimit të të interesuarit dhe, në rastet e kundërshtimit të tij, me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli i institucionit, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shërbyer si shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

3. I burgosuri ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor ka të drejtë:

a) të informohet menjëherë në mënyrë të qartë dhe në një gjuhë që është e kuptueshme prej tij për faktet, shkeljet dhe masat disiplinore që mund të vendosen;

b) të dëgjohet dhe t'i jepen koha dhe lehtësitë e mjaftueshme për të parashtruar pretendime dhe prova në mbrojtje të tij;

c) të asistohet nga një mbrojtës kur kjo kërkohet prej tij;

ç) të kërkojë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve; dhe

d) të përfitojë falas ndihmën e një përkthyesi kur nuk kupton ose flet gjuhën shqipe.

4. I burgosuri me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar ndihmohet nga një interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit.

5. Procedura e dhënies së masave disiplinore për të burgosurin e mitur bëhet në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Rregulla të posaçme lidhur me procedurat e masës disiplinore për të miturit dhe autoritetet përkatëse përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

6. Vendimi i arsyetuar i komisionit disiplinor për marrjen e masës disiplinore merret brenda 20 ditëve nga konstatimi i shkeljes dhe i njoftohet të burgosurit.

Neni 67

Ankimi i masave disiplinore

1. I burgosuri ka të drejtë ta ankimojë masën disiplinore pranë komisionit të apelit të masave disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit për dhënien e masës disiplinore.

2. Komisioni i apelit vendos lënien në fuqi, shfuqizimin ose kthimin për rishqyrtim të vendimit të komisionit disiplinor brenda 14 ditëve nga marrja e ankimit. Komisioni i apelit njofton me shkrim të burgosurin për vendimin e tij.



3. Kundër vendimit të komisionit të apelimit i burgosuri ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente brenda 15 ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit.

4. Masa disiplinore fillon efektin e saj nga momenti i marrjes së një vendimi nga komisioni disiplinor. Masat disiplinore, të parashikuara në shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 1 të nenit 64 të këtij ligji, i fillojnë efektet nga momenti i zbatimit.

5. Masat disiplinore evidentohen në regjistrin e masave disiplinore, në dosjen psikosociale dhe në dosjen personale të të dënuarit menjëherë pas dhënies së vendimit nga komisioni disiplinor. Në rastin kur komisioni i apelimit ose gjykata me vendim të formës së prerë ka vendosur pranimin e ankimit të të burgosurit dhe shfuqizimin e masës disiplinore, masa disiplinore konsiderohet sikur nuk është dhënë dhe ky fakt pasqyrohet në regjistrin e masave disiplinore, në dosjen psikosociale dhe në dosjen personale të të burgosurit.

6. Masat disiplinore konsiderohen sikur nuk janë dhënë në rast mospërsëritje dhe kur nga data e dhënies së tyre kanë kaluar:

a) 6 muaj për masën disiplinore të parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 64 të këtij ligji;

b) 1 vit për masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, dhe “ç” të pikës 1 të nenit 64 të këtij ligji.

7. Rregullat e detajuara për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e komisionit të apelimit përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 68

Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë

1. I burgosuri mund të vendoset nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj kur:

a) rrezikon sigurinë e personelit të institucionit, vizitorëve, ose kur ka rrezik të dëmtojë veten ose të tjerët;

b) ka rrezik të pengojë veprimtarinë e të burgosurve të tjerë nëpërmjet dhunës ose kërcënimeve;

c) ka rrezik të detyrojë të burgosurit e tjerë që t’iu nënshtrohen ose të përfitojnë prej tyre;

ç) pengon të burgosurit e tjerë të mos zbatojnë rregullat individualisht ose në grup ose nxit shkeljen e tyre.

2. Vendosja e të burgosurit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë bëhet me vendim të arsyetuar të drejtorit të institucionit pas marrjes së raportit të vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve. Vendimi i njoftohet menjëherë prokurorit, drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, të burgosurit dhe mbrojtësit të tij.

3. Pas marrjes së vendimit sipas pikës 2 të këtij neni, drejtori i institucionit urdhëron kalimin e të burgosurit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë. I burgosuri ka të drejtë ta ankimojë urdhrin e drejtorit të institucionit në gjykatën kompetente brenda 10 ditëve nga njoftimi i urdhrin.

4. Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë zbatohet në mjediset e brendshme të institucionit ku ndodhet i burgosuri.

5. Vendosja në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë është e ndaluar për të burgosurin e mitur dhe gratë.

Neni 69

Organizimi i regjimit të mbikëqyrjes së veçantë

1. Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë mund të kufizojë, për aq sa është e nevojshme dhe në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm, disa të drejta të parashikuara në këtë ligj vetëm për qëllim të:

a) ruajtjes së rregullit dhe sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;

b) ushtrimit të të drejtave të burgosurve të tjerë.

2. Kufizimet që zbatohen gjatë regjimit të mbikëqyrjes së veçantë nuk mund të cenojnë parashikimet e këtij ligji për sa u takon higjienës, shërbimit shëndetësor, veshjes, ushqimit, mbajtjes, blerjes dhe marrjes së ushqimeve ose objekteve të tjera të parashikuara nga rregullorja e institucionit, aksesit në shërbimin e bibliotekës, lirisë së shprehjes dhe besimit, përdorimit të sendeve personale të lejuara, ajrimin, takimet me mbrojtësin, takimet me anëtarët e familjes e të afërmit.

Neni 70

Përdorimi i forcës fizike dhe i mjeteve shtrënguese

1. Përdorimi i forcës fizike ndaj të burgosurit nuk lejohet, me përjashtim të rasteve kur është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e



dhunshme, sulmin fizik ndaj një të burgosuri tjetër, tentativat e largimit nga institucioni, vetëdëmtimin ose në rast të rezistencës aktive ose pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk duhet të ketë karakter ndëshkues.

2. Masa e forcës së përdorur duhet të jetë në minimumin e mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme.

3. I burgosuri, pas përdorimit të forcës, duhet t'i nënshtrohet ekzaminimit dhe trajtimit mjekësor. Në të gjitha rastet e përdorimit të forcës, punonjësi i institucionit, i cili për çdo lloj arsye ka përdorur forcën fizike ndaj të burgosurit, duhet menjëherë të vërë në dijeni me shkrim drejtorin e institucionit nëpërmjet një raporti, ku jepen arsyet, faktet dhe rrethanat që kanë diktuar nevojën e përdorimit të forcës, në ç'masë dhe me cilat mjete është ushtruar forca, si dhe nëse ka shkaktuar ose jo lëndime fizike tek i burgosuri ose tek personeli i burgjeve.

4. Mjetet e shtrëngimit fizik mund të përdoren për të shmangur përpjekjet për largimin nga institucioni, dhunën ndaj personelit të institucionit, të burgosurve të tjerë, dëmtimin e sendeve, si dhe për të garantuar shëndetin e vetë të burgosurit. Ndalohet përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik si mjet ndëshkimi.

5. Personeli, që merret drejtpërdrejt me të burgosurit, trajnohet paraprakisht para se të marrë detyrën për teknikat që bëjnë të mundur përdorimin minimal të forcës.

6. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik kryhet në mënyrë të përshtatshme, në proporcion me situatën dhe nivelin e rrezikut dhe duhet të jetë i kufizuar në kohë. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik, për një periudhë më të gjatë se 48 orë, bëhet me miratimin e prokurorit.

7. Gjatë shtrëngimit fizik, i burgosuri duhet të jenë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor.

8. Në rastin e të dënuarve të mitur, forca dhe mjetet e shtrëngimit fizik përdoren vetëm në përputhje me rastet e jashtëzakonshme dhe kufijtë e përcaktuar në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Forca dhe mjetet e tjera shtrënguese nuk mund të përdoren në asnjë rast për të miturën shtatzënë, përveç rastit kur ajo ka për qëllim të vetëdëmtohet.

Neni 71

Llojet dhe natyra e forcës dhe e mjeteve të shtrëngimit

1. Ndalohet përdorimi i mjeteve të forcës dhe atyre shtrënguese, që konsiderohen armë, ose i lëndëve narkotike në kuptim të Kodit Penal.

2. Në çdo rast, ndalohet përdorimi i forcës për qëllime të torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose degradues. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit nuk duhet të tejkalojë kufizimet e vendosura në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

3. Punonjësit e shërbimit brenda institucionit nuk duhet të mbajnë armë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.

4. Rregullat e hollësishme për llojet, mënyrat, natyrën, teknikat e përdorimit të forcës dhe të mjeteve të shtrëngimit, si dhe rregullat dhe masa e përdorimit të tyre me funksion parandalues dhe në përputhje me individualitetin e të burgosurit përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve

KREU II

LEJET, SHPËRBLIMET DHE NDRYSHIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 72

Lejet shpërblyese

1. Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës, rregulloren e brendshme të institucionit, janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegrit, si dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, por jo më shumë se 20 ditë në vit. Për të dënuarit e mitur kohëzgjatja e lejeve shpërblyese në total përcaktohet në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Leja shpërblyese i jepet në rastin e përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

a) të dënuarit deri në 3 vjet burgim, pasi të ketë kryer jo më pak se 1/4 e dënimit;

b) të dënuarit nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të ketë kryer jo më pak se 1/2 e dënimit;

c) të dënuarit mbi 10 vjet burgim, pasi t'i ketë mbetur për të kryer më pak se 5 vjet heqje lirie.

3. Leja shpërblyese në institucionet e sigurisë së lartë jepet vetëm me urdhër të ministrit të



Drejtësisë ose me autorizimin e tij nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

4. Leja shpërblyese në institucionet e sigurisë së zakonshme dhe të ulët jepet me urdhër të drejtorit të institucionit.

5. Brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për leje, organi përgjegjës vendos miratimin ose refuzimin e kërkesës, duke u bazuar në planifikimin vjetor dhe raportet e vlerësimit për përmbushjen e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

6. Kundër vendimit të refuzimit të lejes shpërblyese, i dënuari në institucionet e sigurisë së zakonshme ose të sigurisë së ulët apo përfaqësuesi i tij ligjor mund të paraqesë ankim brenda 5 ditëve pranë ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente. Kundër vendimit të refuzimit të lejes shpërblyese i dënuari në institucionet e sigurisë së lartë ose përfaqësuesi i tij ligjor, mund të paraqesë ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

7. Procedurat e dhënies së lejeve shpërblyese përcaktohen me udhëzim të ministrit të Drejtësisë.

Neni 73

Leje të veçanta

1. I burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.

2. Leja e veçantë për të dënuarin jepet nga drejtori i institucionit, ndërsa për të paraburgosurin jepet nga drejtori i institucionit, me pëlqimin paraprak të prokurorit.

3. Leja e veçantë jepet për një kohëzgjatje deri në 48 orë. Leja e veçantë mund të zgjatet me kërkesë të të burgosurit edhe 24 orë të tjera vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, të cilat vërtetohen me dokumentacionin përkatës. Zgjatja e lejes miratohet në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

4. Kundër vendimit të drejtorit të institucionit për refuzimin e lejes së veçantë mund të bëhet

ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja e tij dhe vendimit të refuzimit.

5. Vendimi për dhënien e lejes së veçantë u njoftohet menjëherë strukturave të Policisë së Shtetit, të juridiksionit të vendit ku do të qëndrojë i burgosuri.

6. Rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesës për leje të veçantë dhe dokumentacioni shoqërues përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 74

Detyrimet gjatë lejes dhe përgjegjësia për shkeljet

1. I burgosuri është i detyruar të respektojë kohëzgjatjen e lejes, ta kryejë atë në vendin e detyrueshëm të qëndrimit, të respektojë detyrimet dhe kufizimet e vendosura dhe të njoftojë institucionin për çdo shmangie të imponuar.

2. Në rast mosrespektimi të rregullave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale vendos ndërprerjen e lejes dhe paraqet kallëzim penal kur konstaton se ka elemente të veprës penale të largimit të të burgosurit nga vendi i qëndrimit, sipas parashikimeve të Kodit Penal.

Neni 75

Ulja e dënimit

1. I dënuari që zbaton rregullat e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe ka një sjellje të mirë duke e treguar me pjesëmarrje aktive dhe pozitive në veprimtaritë rehabilituese dhe riintegruuese gjatë kryerjes së dënimit, bazuar në raportin e vlerësimit, që përgatitet nga institucioni, mund të përfitojë ulje dënimi deri 90 ditë në çdo vit të kryerjes së dënimit. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit.

2. Ulja e dënimit për të dënuarit që plotësojnë kriteret e këtij neni, fillon jo më parë se 12 muaj nga fillimi i kryerjes së dënimit me burgim, në zbatim të vendimit gjyqësor penal të formës së prerë.

3. Ulje dënimi nuk mund të jepet pa kaluar të paktën 12 muaj nga ulja e fundit e përfituar.



4. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

5. Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit, ose të përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucionit.

6. Rregullat e detajuara për kriteret, procedurën dhe formatin e raportit të vlerësimit, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 76

Ndryshimet në gjendjen civile

1. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale evidenton në një regjistër të veçantë faktet e lindjeve, martesave ose vdekjeve të ndodhura në institucion.

2. Drejtori i institucionit informon menjëherë organet kompetente për të bërë shënimet përkatëse në regjistrin kombëtar të gjendjes civile, sipas legjislacionit në fuqi për gjendjen civile.

3. Në rast vdekjeje të të burgosurit, institucioni merr masa për kryerjen e procedurave ligjore, që kanë të bëjnë me verifikimin e rastit, shkakun e vdekjes, kryerjen e veprimeve procedurale hetimore, si dhe veprimeve të tjera për sqarimin dhe dokumentimin e faktit të vdekjes.

4. Drejtori i institucionit informon menjëherë prokurorinë, gjykatën, anëtarët e familjes dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për vdekjen e të burgosurit.

5. Sendet personale dhe mjetet monetare të të burgosurit u dorëzohen anëtarëve të familjes sipas procedurave dhe dokumentacionit përkatës.

6. Në rast se i burgosuri nuk merret nga anëtarët e familjes ose të afërmit e tij, personeli i institucionit kujdeset për varrosjen e tij në varrezat publike, duke përballuar shpenzimet e nevojshme dhe duke bërë shënimin e duhur në regjistrin themeltar. Për vdekjen e të burgosurit me shtetësi të huaj ose person pa shtetësi dhe për vendosjen e tij në varrezat publike njoftohet ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

7. Ministria e Drejtësisë, ministria përgjegjëse për gjendjen civile dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e këtij neni.

Neni 77

Mjetet monetare të të burgosurit

1. I burgosuri nuk mund të mbajë mjete monetare gjatë qëndrimit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

2. Nëse i burgosuri në momentin e ardhjes në institucion posedon mjete monetare, ato vendosen në llogarinë bankare të hapur në emrin e tij, përveç rasteve kur ai vendos ndryshe.

3. Rregullat e detajuara për shumat e mjeteve monetare, të cilat i burgosuri i disponon lirisht dhe shuma që ai depoziton në llogari kursimi, përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

KREU III

TRANSFERIMET DHE LIRIMI

Neni 78

Rregullat e transferimit

1. Transferimi i të burgosurit bëhet për arsyet e mëposhtme:

- a) kur cenohet rendi dhe siguria në institucion;
- b) kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të burgosurit nga të tjerët;
- c) kur ka mbipopullim në institucion;
- ç) për nevoja të hetimit dhe gjykimit;
- d) për shkaqe shëndetësore dhe familjare;
- dh) për shkak të zbatimit të programit të formimit profesional;
- e) në zbatim të urdhrit të ekzekutimit të prokurorisë për vendimet gjyqësore të formës së prerë.

2. Transferimi i të burgosurit bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në kërkesën e të burgosurit ose anëtarëve të familjes së tij, prokurorit të çështjes ose drejtorit të institucionit.

3. Në rast të refuzimit të kërkesës së transferimit, i burgosuri njoftohet me shkrim. Kundër vendimit të refuzimit i burgosuri ka të drejtë të paraqesë ankim pranë ministrit të Drejtësisë brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

4. Transferimet krijojnë, për aq sa është e mundur, mundësinë që të dënuarit ta kryejnë dënimin sa më pranë vendbanimit të anëtarëve të familjes së tyre.



5. Transferimi i të burgosurit të huaj mban në konsideratë, për aq sa është e mundur, lidhjet familjare, gjuhësore, kulturore, sociale e ekonomike dhe kushtet e burgjeve në shtetin ku ai do të vuajë dënimin, para marrjes së vendimit të formës së prerë, me qëllim lehtësimin e riintegrit të tij dhe respektimin e të drejtave të tij.

6. I burgosuri, përpara transferimit, i nënshtrohet kontrollit personal dhe vizitohet nga mjeku, i cili verifikon gjendjen e tij fizike dhe psikologjike.

7. Për transferimin e të paraburgosurve njoftohet organi procedues përkatës, prokuroria dhe/ose gjykata.

8. I burgosuri i mitur mund të transferohet në një institucion tjetër për të mitur në qoftë se një masë e tillë është e domosdoshme për sigurinë e tij ose për sigurinë e të miturve të tjerë. Për transferimin e të burgosurit të mitur njoftohet menjëherë prindi ose kujdestari i tij ligjor. Në rastin e të dënuarit të mitur, që arrin moshën madhore dy muaj para lirimit të tij, autoritetet kompetente duhet të shqyrtojnë, rast pas rasti, mostransferimin e tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale për të rritur.

9. I burgosuri transferohet së bashku me sendet vetjake, dosjen personale dhe dosjen psikosociale.

10. Rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për transferim, procedurën e shqyrtimit të saj dhe ekzekutimin e transferimit përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 79

Lirimi

1. Lirimi i të dënuarit bëhet kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit ose, në bazë të ligjit, me vendim të organit kompetent. Personeli i institucionit kryen veprimet bazuar në urdhrin me shkrim të drejtorit të institucionit.

2. Të liruarit që nuk ka mjete të mjaftueshme financiare, me urdhër të drejtorit të institucionit i sigurohet ndihma e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të transportit deri në vendbanimin e tij në masën dhe sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

3. Për të mbështetur procesin e riintegrit të të liruarit në rastet kur rezulton se ai do të përballen me vështirësi pas daljes nga institucioni, njoftohet njësisë përkatëse e vetëqeverisjes vendore e

vendbanimit të tij për të mundësuar asistencë të mëtejshme.

4. Për të dënuarin e mitur është i detyrueshëm njoftimi paraprak i prindërve ose kujdestarit të tij ligjor. Mbështetja pas lirimit të të miturve, me qëllim riintegrimin e tyre në shoqëri, bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

5. Për të dënuarën grua, para lirimit nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, përcaktohet një plan rehabilitimi sipas nevojave specifike të tyre, i cili ndiqet nga struktura përgjegjëse vendore e shërbimit social pranë vendbanimit ose vendqëndrimit të të dënuarës.

6. Gjikata që ka dhënë vendimin, prokurori që ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe Policia e Shtetit njoftohen menjëherë për lirimin e të dënuarit dhe në raste të veçanta edhe paraprakisht. Për shtetasit e huaj njoftohet ministria përgjegjëse për punët e jashtme nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

7. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale pajis të liruarin me një vërtetim në të cilin saktësohen kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit, uljet dhe përfitimet për shkak të ligjit, si dhe kohëzgjatja e lloji i punës së kryer në institucion.

8. Me kërkesën e të liruarit, institucioni mund të lëshojë vërtetim me të dhëna për aftësimin profesional të fituar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe për qëndrimin dhe sjelljen e tij brenda institucionit.

PJESA E PESTË

SHQYRTIMI GJYQËSOR I ANKIMEVE DHE ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 80

Gjykata kompetente

Kundër vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve mund të bëhet ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.



Neni 81

Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues dhe kompetencat e tij

1. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim mekanizmi kombëtar, i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:

a) vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, paraburgimit dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 82

Garancitë në veprimtaritë e mekanizmit kombëtar

Mekanizmit kombëtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij i garantohet:

a) marrja e çdo informacioni për numrin e individëve që u është hequr liria në vendet e privimit të lirisë, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;

b) marrja e të gjithë informacionit për trajtimin e këtyre individëve, si dhe për kushtet e tyre të ndalimit;

c) aksesimi në të gjithë dokumentacionin që mbahet dhe administrohet nga institucioni në përputhje me funksionet e kryera prej tij, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) hyrja lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit, pa njoftimin paraprak. Në funksion të realizimit të kësaj të drejte, mekanizmi kombëtar mund të përdorë pajisje të tilla, si: aparat fotografik, pajisje për matjen e temperaturës dhe lagështirës së ambientit, për matjen e kurbaturave dhe sipërfaqeve të

dhomave të banimit, aparate specifike për regjistrimin e ankesave;

d) kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët të cilëve u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm;

dh) zgjedhja lirisht e vendeve që kërkon të vizitojë dhe e individëve që kërkon të intervistojë.

Neni 83

Format e mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja e mekanizmit kombëtar realizohet nëpërmjet:

a) pranimit të kërkesave ose ankesave nga të burgosurit, ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe organizatat të cilat e ushtrojnë këtë të drejtë, pasi të jetë dhënë pëlqimi paraprak nga ana e të burgosurit;

b) marrjes së informacionit, ankesave ose kërkesave të të burgosurit, ose nga individë që kanë statusin e vizitorit, ose të organeve shtetërore, ose organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë kontrolluar ose vizituar institucionin sipas kompetencës që u njeh ligji, si dhe nga mbrojtësi i të burgosurit;

c) kërimit të informacioneve nga personeli i institucionit;

ç) verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të burgosurin, brenda dhe jashtë institucionit.

2. Për realizimin e procesit të mbikëqyrjes, mekanizmi kombëtar mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe, pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrit të vërejtjeve.

Neni 84

Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta e informimit

1. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të të burgosurve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.



2. Vënia në dispozicionin e informacionit për publikun dhe MEDIAN bëhet në përputhje me rregullat, procedurën dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

3. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në njoftimet publike duhet të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdiskriminimit, etikën profesionale dhe dinjitetin e personave të burgosur, veçanërisht të të miturve.

4. Rregullat e hollësishme për natyrën dhe llojin e informacionit, që vihet në dispozicion të medias dhe publikut, dhe autoritetin përgjegjës për dhënien e tij përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 85

Inspektimi nga institucionet shtetërore

1. Ministria e Drejtësisë, shërbimi i kontrollit të brendshëm në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë organet kompetente shtetërore për kryerjen e inspektimeve pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

2. Personat e autorizuar, me urdhër të ministrit të Drejtësisë ose drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, gëzojnë të drejtën të inspektojnë institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të bëjnë verifikime me objekt të përgjithshëm ose tematik.

3. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, objekt i inspektimit janë vlerësimi i respektimit të parashikimeve të këtij ligjit lidhur me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si edhe çështjet konkrete të përcaktuara në urdhrin e inspektimit.

4. Pas përfundimit të inspektimit, personat e autorizuar për kryerjen e inspektimeve, përgatisin rekomandimet, sipas rastit, për ministrin e Drejtësisë, drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, ose drejtorin e institucionit për marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara.

5. Rregullat e detajuara për kryerjen e inspektimeve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të drejtat dhe detyrat e inspektorëve dhe subjekteve të inspektuara përcaktohen në legjislacionin në fuqi për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 86

Monitorimet e pavarura

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale krijojnë kushtet e nevojshme për kryerjen e monitorimeve të pavarura nga organizata ose agjenci ndërkombëtare dhe nga institucione shtetërore, që gëzojnë të drejtën të vizitojnë institucionet dhe të monitorojnë kushtet e mbajtjes dhe trajtimit të të burgosurve.

PJESA E GJASHTË

TRAJTIMI I TË PARABURGOSURVE

Neni 87

Trajtimi dhe vendosja e të paraburgosurve

1. Personat e paraburgosur gëzojnë të gjitha të drejtat që gëzojnë edhe të dënuarit me burgim.

2. Të paraburgosurit trajtohen me dinjitet dhe humanizëm. Në respekt të parimit të prezumimit të pafajësisë, asnjë i paraburgosur nuk mund të trajtohet si i dënuar ose si person që mund të dënohet në të ardhmen.

3. Brenda regjimi të institucionit, të paraburgosurit u nënshtrohen rregullave të parashikuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve dhe në rregulloren e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

4. Në çdo rast, të paraburgosurit mbahen në seksione të veçuara nga seksioni i të dënuarve me burgim.

5. Të paraburgosurit e mitur vendosen vetëm në seksionin për të mitur në mjediset e paraburgimit veçmas nga të paraburgosurit e rritur. Të paraburgosurat e mitura femra vendosen veçmas nga të paraburgosurit e mitur meshkuj dhe mbahen vetëm nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e personelit të së njëjtës gjini.

6. Të paraburgosurat femra vendosen në dhoma ose seksione të veçanta nga meshkujt dhe mbahen vetëm nën mbikëqyrjen e kujdesin e personelit të së njëjtës gjini.



Neni 88

Pranimi i të paraburgosurve në institucion dhe lirim

1. Pranimi i të paraburgosurve kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 38 të këtij ligji dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”;
- b) procesverbalin e ndalimit ose të arrestit në flagrancë;
- c) procesverbalin e kontrollit personal;
- ç) dokumentin e kontrollit mjekësor;
- d) formularin e identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve;
- dh) certifikatën personale dhe dokumentin e identifikimit dhe në mungesë të tyre, dokument identifikimi të përgatitur nga Policia e Shtetit.

2. Lirimi i personave të paraburgosur bëhet vetëm me vendim të gjykatës ose të prokurorisë. Në rastet kur i paraburgosuri i liruar nuk ka mundësi strehimi ose transporti pranë familjes së tij, drejtori i institucionit në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe organizatat e tjera mundësojnë sistemimin dhe transportin e tij.

3. Në rast pamundësie objektive për t’u larguar nga institucioni pas lirim, personit të paraburgosur, me kërkesën e tij, i mundësohet strehimi në institucion, në një ambient të përshtatshëm për banim, deri në përfundimin e pengesës objektive për largim.

4. Drejtuesi i institucionit bashkëpunon me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit të personit për të mundësuar strehimin e tij në një nga programet që parashikon legjislacioni në fuqi për strehimin social ose e orienton për procedurat që mund të ndjekë.

Neni 89

Të drejtat e të paraburgosurve

1. Personat e paraburgosur, që ndodhen në institucionet e paraburgimit ose seksionet e paraburgimit, gëzojnë të drejtat e përcaktuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 32-50, 58-67 të këtij ligji, si dhe të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë seksion të ligjit.

2. Të paraburgosurit lejohen të informojnë menjëherë familjen për arrestimin dhe për

vendndodhjen e tyre. Atyre u krijohen të gjitha kushtet e nevojshme të takohen me anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur kjo pengon ose nuk është në interes të zhvillimit të hetimit dhe gjykimit. Të paraburgosurit e huaj lejohen të informojnë përfaqësinë konsullore ose diplomatike të vendit të tyre. Në rastin kur i paraburgosuri është person pa shtetësi apo refugjat, ai lejohet të njoftojë një organizatë ndërkombëtare.

3. Drejtori i institucionit të paraburgimit kufizon të drejtën e të paraburgosurit për të pritur vizita, për korrespondencë apo për biseda telefonike, kur është e nevojshme, për kryerjen e veprimeve procedurale penale të urdhëruara nga organi procedues përkatës.

4. Në asnjë rast të paraburgosurit nuk mund të detyrohen të punojnë. Nëse të paraburgosurit zgjedhin të punojnë, ata u nënshtrohen kushteve të njëjta të punës me ato të parashikuara për të dënuarit me burgim.

Neni 90

Ndihma juridike

1. Të paraburgosurit informohen në çdo rast për të drejtën për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose kur nuk kanë mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

2. Mjediset ku mbahen të paraburgosurit duhet të ofrojnë mundësinë që ata të takohen privatisht dhe të komunikojnë me mbrojtësit dhe të kenë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen gjatë gjithë gjykimit.

3. Të paraburgosurit të mitur i garantohet ndihmë juridike dhe psikologjike, si dhe ushtrimi i të gjitha të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

PJESA E SHTATË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 91

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë rregulloren e përgjithshme të burgjeve.



2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32, pika 2, 43, pika 12, dhe 44, pika 1, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të nxjerrë urdhrat dhe udhëzimet në zbatim të këtij ligji brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në rast se nuk parashikohet një afat i ndryshëm në këtë ligj.

4. Ngarkohet ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë që brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 36, pika 8, 41, pikat 13 dhe 17, të këtij ligji.

5. Ngarkohet ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional që brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 45, pika 9, të këtij ligji.

6. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve që brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e rregullores së përgjithshme të burgjeve, të miratojë rregulloret e brendshme të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 92

Shfuqizime

1. Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, për aq sa nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Neni 93

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.6.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11547, datë 15.7.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr. 11547, datë 15.7.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 561, datë 15.7.2020

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË FSHATIN LALËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miraturar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Shpalljen e territorit prej 27.500 m², në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, zonë e re për zhvillim, sipas hartës dhe koordinatave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe





Pika	Koord_X	Koord_Y
1	380958.728	4599367.751
2	380963.0143	4599351.717
3	380978.7041	4599332.534
4	381008.139	4599276.641
5	381025.0063	4599251.175
6	381040.8813	4599226.701
7	381046.5037	4599214.795
8	381050.8032	4599191.974
9	381053.7538	4599173.948
10	381053.7798	4599163.531
11	381049.4803	4599156.586
12	381038.2355	4599149.31
13	381014.0922	4599133.766
14	380999.5401	4599120.537
15	380982.6729	4599111.607
16	380973.4124	4599110.284
17	380926.1181	4599120.206
18	380894.6208	4599131.631
19	380893.4042	4599135.047
20	380901.9748	4599156.917
21	380911.2793	4599182.116
22	380908.8691	4599221.386
23	380903.9592	4599235.961
24	380903.9592	4599246.214
25	380906.9469	4599252.705
26	380923.1415	4599287.886
27	380925.7873	4599299.131
28	380926.4488	4599308.722
29	380926.4488	4599314.675
30	380924.4644	4599319.305
31	380912.8889	4599329.889
32	380905.6605	4599337.565
33	380906.3229	4599342.665
34	380916.324	4599353.639
35	380913.2196	4599377.183
36	380920.2654	4599383.844
37	380931.4097	4599394.381
38	380949.9306	4599396.696
39	380970.1833	4599384.035
40	380965.7206	4599373.263
41	380958.728	4599367.751

VENDIM**Nr. 562, datë 15.7.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT
OSE TË RIPARIMIT TË BANESAVE
INDIVIDUALE, TË NJËSIVE TË
BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), SI
DHE MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI
OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA
(PALLAT), NË BASHKITË KURBIN,
SHIJAK DHE DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 1 349 321 530,38 (një miliard e treqind e dyzet e nëntë milionë e treqind e njëzet e një mijë e pesëqind e tridhjetë presje tridhjetë e tetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, dhe rikonstruksionit ose riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në bashkitë Kurbin, Shijak dhe Durrës.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi prej 830 944 728,38 (tetëqind e tridhjetë milionë e nëntëqind



e dyzet e katër mijë e shtatëqind e njëzet e tetë presje tridhjetë e tetë) lekësh, për:

i. financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në masën 470 750 000 (katërqind e shtatëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

ii. financimin për rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në masën 360 194 728,38 (treqind e gjashtëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet e tetë presje tridhjetë e tetë) lekë.

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi prej 127 176 802 (njëqind e njëzet e shtatë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dy) lekësh për financimin për rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat).

c) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 391 200 000 (treqind e nëntëdhjetë e një milionë e dyqind mijë) lekësh për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kurbin, Shijak dhe Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR

Nr. 163, datë 16.6.2020

PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT B, PËR INSTALIMET EKZISTUESE TË PAJISURA ME LEJE MJEDISI TË TIPIT C, TË CILAT, NË VARËSI TË KAPACITETIT PRODHUES, KLASIFIKOHEN SI LEJE MJEDISI TË TIPIT B, SI DHE RREGULLAT E HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA QKB-ja

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 10, të dispozitës kalimtare, të ligjit nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, ‘Për lejet e mjedisit’”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e aplikimeve për leje mjedisi të tipit B, për instalimet ekzistuese të pajisura me leje mjedisi të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit prodhues, klasifikohen si leje mjedisi të tipit B, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga QKB-ja, si më poshtë vijon:

1. Rregullat e hollësishme për shqyrtimin e aplikimeve:

a) subjektet e pajisura me leje mjedisi të tipit C, për instalimet ekzistuese, të cilat, në varësi të kapacitetit prodhues, klasifikohen si leje mjedisi të tipit B, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 ‘Për lejet e mjedisit’”, i ndryshuar”, të aplikojnë pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për pajisjen me leje mjedisi të tipit B, si aplikim i ri;

b) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), brenda 10 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri, inventarizon dhe verifikon nëpërmjet drejtorive rajonale të mjedisit të gjitha instalimet që operojnë me lejen e mjedisit të tipit C;

c) pas kryerjes së inventarizimit dhe verifikimit të instalimeve ekzistuese të tipit C, AKM-ja, brenda 5 ditëve pune, identifikon instalimet të cilat janë të pajisura me lejen e mjedisit të tipit C, të cilat, në



varësi të kapacitetit prodhues, klasifikohen për leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar;

d) AKM-ja, brenda 20 ditëve pune nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, njofton me shkrim të gjitha subjektet e riklasifikuara për leje mjedisi të tipit B, mbi detyrimin e aplikimit pranë QKB-së, për t’u pajisur me lejen e mjedisit;

e) pas njoftimit nga AKM-ja, kërkuesi aplikon pranë QKB-së së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B, me dokumentacionin sipas pikës 2 të këtij urdhri.

2. Dokumentacioni i posaçëm që duhet të dorëzojë kërkuesi për aplikimin pranë QKB-së:

a) shkresën e AKM-së, sipas shkronjës “d”, të pikës 1, të këtij urdhri;

b) kopjen e lejes ekzistuese të tipit C;

c) formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, të VKM-së nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar;

d) mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas VKM-së nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”;

e) raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet;

f) raportin e fundit të vetëmonitorimit të dorëzuar sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në lejen e mjedisit të tipit C dhe në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi, lidhur me funksionimin e instalimit ekzistues;

g) vetëdeklarim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve financiare (tarifë vjetore dhe gjoba), shoqëruar me kopje të mandatpagesave të kryera, nëse ka;

h) çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit.

3. Afatet për shqyrtimin e aplikimeve për leje mjedisi të tipit B, për instalimet ekzistuese të pajisura me leje mjedisi të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit prodhues, klasifikohen si leje mjedisi

të tipit B, janë sipas kreut III, të VKM-së nr. 419, datë 25.6.2014.

4. Në rast se instalimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të këtij urdhri, nuk kanë aplikuar për leje mjedisit të tipit B dhe vazhdojnë funksionimin e tyre, pas kalimit të afatit 1-vjeçar të hyrjes në fuqi të ligjit, këto instalime do të konsiderohen se ushtrohen pa lejen përkatëse mjedisore dhe do të jenë subjekt kontrolli dhe vendosjes së masave administrative nga strukturat përgjegjëse të inspektimit të mjedisit, në zbatim të dispozitave të ligjit për lejet e mjedisit.

5. Operatorët e pajisur me licencë III.2.B, që janë, gjithashtu, subjekt i këtij ndryshimi ligjor, pas miratimit të lejes së mjedisit të tipit B, sipas procedurave të këtij urdhri, detyrohen të zbatojnë kushtet e kësaj leje mjedisore.

6. Instalimet ekzistuese, të cilat riklasifikohen, në varësi të kapacitetit prodhues, si leje mjedisi të tipit B, të plotësojnë rregullat e hollësishme dhe dokumentacionin e posaçëm, sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

II. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe strukturat përgjegjëse për kontrollin e mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Blendi Klosi



VENDIM
Nr. 99, datë 24.6.2020

**MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË
VENDIMIT TË ERE-s NR. 43, DATË
15.3.2017, “MBI MIRATIMIN
PËRFUNDIMTAR TË CERTIFIKIMIT
TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE OST SHA, NË PËRPUTHJE
ME NENIN 54, PIKA 6, TË LIGJIT NR.
43/2015, “PËR SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR, DHE
ME NENIN 9, PIKA 6, TË DIREKTIVËS
72/2009 EC, “MBAS MARRJES SË
OPINIONIT TË SEKRETARIATIT TË
KOMUNITETIT TË ENERGJISË”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurës administrative”; si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 75/4 prot., datë 16.6.2020, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, ka vendosur miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC.

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 207, datë 16.12.2019, ka vendosur:

Të miratojë kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2, të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.”, në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë Elektrike”, të

ndryshuar dhe me nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC, “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në datën 16.6.2020.

- ERE iu drejtua shoqërisë OST sh.a., me shkresën nr. 736 prot, datë 2.6.2020, duke i kërkuar informacion mbi ecurinë e plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin e ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, afati i plotësimit të të cilave është shtyrë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 16.12.2019.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 743 prot., datë 3.6.2020, ka përçjellë informacion në lidhje me përmbushjen e kushteve të parashikuara në vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”, në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe me nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC, “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, të ndryshuar.

- Kushti i paplotësuar, referuar më sipër, ka të bëjë me: “Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave të Ministria e Ekonomisë”.

- OST sh.a. bëri me dije, se në ndryshimet e miratuara të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në datën 14 maj 2020, ndër të tjera janë reflektuar edhe ato që çojnë në plotësimin e këtij kushti.

- Sa më sipër, nga ana e ERE-s është konstatuar se Parlamenti Shqiptar, me ligjin nr. 61/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime të cilat konstatojnë në: neni 31, pika 1:

Ishte: “Linjat e reja të interkoneksionit, që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë”.

Bëhet: “Linjat e reja të interkoneksionit, që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë”.



- Pika 8, e nenit 60, me përmbajtje: “ERE, në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë.”, shfuqizohet.

- Me miratimin e ndryshimeve ligjore si më sipër, rezulton se shoqëria OST sh.a., ka plotësuar tërësisht kushtet e parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017.

- Referuar kushtit të vendosur në pikën 2, paragrafi i parë, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, OST sh.a., ka detyrimin që çdo vit të paraqesë në ERE informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC, “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, të ndryshuar.

2. OST sh.a. të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore t’u njoftojë këtë vendim OST sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Autoritetit të Konkurrencës, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 100, datë 24.6.2020

**MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË
BORDIT TË ERE-s NR. 27, DATË
30.1.2018, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘HEC LLËNGË’ SHPK, NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
‘LLËNGA 1’, ME FUQI 1730 kw, HEC
‘LLËNGA 2’, ME FUQI 300 kw DHE HEC
‘LLËNGA 3’, ME FUQI 1500 kw, ME FUQI
TOTALE 3530 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 3 dhe 113 të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të neneve 8 dhe 10, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 75/5 prot., datë 17.6.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.1.2018, mbi licencimin e shoqërisë “HEC Llëngë” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Llëngë” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.1.2018, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Llënga 1”, me fuqi 1730 kw, HEC “Llënga 2”, me fuqi 300 kw, HEC “Llënga 3”, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw, me kusht që përpara fillimit të operimit të depozitonte në ERE, miratimin përfundimtar të lejes së ujit para vënies në operim të veprës.

- Rezulton se shoqëria “HEC Llëngë” sh.p.k. është futur në operim pa bërë me dije ERE-n për plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 27/2018.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 318/5 prot., datë 4.6.2020, shoqëria “HEC Llëngë” sh.p.k. ka depozituar në ERE “Leje për përdorim të burimit ujor” nr. 82/1 prot., datë 5.11.2018, “Leje për përdorim të burimit ujor” nr. 83/1 prot., datë 5.11.2018, si dhe “Leje për përdorim të



burimit ujqor” nr. 84/1 prot., datë 5.11.2018, të lëshuara nga Këshilli i Basenit Ujqor – Shkumbin, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 27/2018.

- Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., së fundi ka bërë me dije ERE-n që ka filluar procedurën për përfundimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike me shoqërinë “HEC Llëngë” sh.p.k., sipas informacionit të bërë me dije nga ERE, se nuk rezulton të jenë plotësuar kushtet e parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.1.2018.

- ERE i ka kthyer përgjigje “FTL” sh.a., duke e informuar se po shqyrton dokumentacionin e depozituar nga shoqëria dhe se do të njoftohet në vijim mbi vendimmarrjen e ERE-s.

- Rezulton se shoqëria “HEC Llëngë” sh.p.k. ka depozituar në ERE dokumentacionin e kërkuar si kusht i pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.1.2018, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin e vendosur në vendimin e licencimit.

- Depozitimi i miratimit përfundimtar të lejes së ujit pas fillimit të operimit nuk afekton detyrimet që lindin nga kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike të lidhur mes shoqërisë “HEC Llëngë” sh.p.k. dhe OSHEE sh.a., duke vlerësuar kohën e dhënies së kësaj leje.

- Kontrata është nënshkruar dhe operimi i veprës ka filluar, pas pajisjes me leje, siç edhe kërkon pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.1.2018, “Për licencimin e shoqërisë “HEC Llëngë” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Llënga 1”, me fuqi 1730 kw, HEC “Llënga 2”, me fuqi 300 kw, HEC “Llënga 3”, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.1.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Llëngë” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Llënga 1”, me fuqi 1730 kw, HEC “Llënga 2”, me fuqi 300 kw dhe HEC “Llënga 3”, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale 3530 kw”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë shoqërinë e licencuar dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 101, datë 24.6.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SEKA
HYDROPOWER” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et
“SEKË”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 12667 kw DHE “ZAIS”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2295 kw,
ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR
14962 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3, dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 747 prot., datë 5.6.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.



- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i nenit 8, të kontratës së koncesionit nr. 7030 rep., nr. 2134 kol., datë 12.6.2013, “Kontratë koncesioni e formës BOT (ndërtim, operim, transferim) për ndërtimin e hidrocentralit “Sekë”, të lidhur midis METE-s (sot MIE) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Hydro-Project” sh.p.k. dhe “Gener 2” sh.p.k. Kjo shoqëri është regjistruar pranë QKB-së në datën 16.9.2013, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE:

- Certifikatë për vërtetim titulli “Në përdorim”, e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Mirditë, në datën 17.7.2017. Në këtë certifikatë janë pasqyruar: Zona kadastrale 3874, nr. pasurie 218, vol. 2, faqe 150, adresa e pasurisë: Zais, Mirditë.

- Kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik” me nr. 83, prot., datë 10.1.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Mat, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit. Në objektin e saj, kjo kontratë ka dhënie me qira të fondit pyjor/kullosor 11.8321 km, me qëllim hapje kanalesh, shtrirje tubacionesh, ndërtim rruge, linjë tensioni 35 kV, për ndërtimin e impianteve hidroelektrike “Sekë” dhe “Zais” mbi lumin Uraka dhe përroin e Melthit dhe 2.3878 ha sipërfaqe në përdorim, në administrim dhe në pronësi të Bashkisë Mat. Afati i kësaj kontrate është 6-vjeçar, me të drejtë rinovimi, duke filluar nga e nesërmja e nënshkrimit të saj nga palët.

- Kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të sipërfaqeve fond pyjor dhe kullosor në administrim të Bashkisë Mirditë, në funksion të ndërtimit të HEC-it të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. me nr. 83 prot., datë 10.1.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Mirditë, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit. Në objektin e saj kjo kontratë ka dhënie me qira të sipërfaqes prej 2.03 ha dhe 3.946 km, me qëllim ndërtimin e linjës gjatësore, kanale tubacione, 1.416 km, linja gjatësore, shtrirje linje elektrike të nëndheshme 2.0704 km, ndërtim rrugë në vendin e quajtur ekonomia pyjore/kullosore Kunor-Valmor në Selitë në administrim të Bashkisë Mirditë për shoqëri “Seka Hydropower” sh.p.k. Afati i kësaj kontrate do të jetë 10-vjeçar, duke filluar nga data 26.2.2018 deri

më 25.2.2028, me të drejtë rinovimi, ku secila palë njofton palën tjetër një muaj përpara përfundimit të saj për të negociuar zgjatjen e afatit.

- Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit me nr. 4899 prot., datë 12.9.2017, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OST sh.a., për HEC-et “Sekë” dhe “Zais”, të cilat do të lidhen në rrjetin 110 kV të transmetimit nëpërmjet një trakti transformatori 110 kV në nënstacionin 110/6.3 kV, HEC Prellë. Kjo do të realizohet nëpërmjet lidhjes me sistemin e zbarrave 110 kV në nënstacionin 110/6.3 kV HEC “Prellë” dhe një transformimi 110/35 kV, me fuqi transformatorike 25 mVA, në këtë nënstacion.

- Leje për përdorim të burimit ujor” me nr. 179 prot., datë 17.9.2018, të miratuar nga KBU Mat, me vendimin nr. 24, datë 12.9.2018, për shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., me qëllim përdorimin e burimit të ujit të Përroit të Melthit, degë e lumit të Urakës, degë e lumit Mat, për HEC-et “Sekë” dhe “Zais”. Periudha e vlefshmërisë së saj është e barabartë me atë të kontratës së koncesionit të formës BOT. Kjo leje është e vlefshme për këtë aplikim.

- Deklaratë mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 6220 prot., datë 19.7.2018, me nr. 533 identifikimi dhe nr. 33 vendimi, për personin juridik “Seka Hydropower” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin, ndërtim i HEC-eve “Sekë” dhe “Zais”. Kjo deklaratë mjedisore është lëshuar për kapacitetin total të instaluar të HEC-eve “Sekë” dhe “Zais”, 14962 kw, me vendndodhje mbi lumin e Urakës dhe përroit të Melthit, Bashkia Mat dhe Mirditë, e cila përkon me kontratën e koncesionit, me kërkesën e shoqërisë dhe me marrëveshjen e lidhjes me rrjetin. Kjo leje konsiderohet e vlefshme për këtë aplikim.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit apo plotësimin e saktësimin, që ka të bëjë me:

- dokumentet e parashikuara në nenin 9, pika 2, germa “d” (Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë): plotësuar pjesërisht.

- dokumentacioni financiar dhe fiskal.

- dokumentet e parashikuara në nenin 9, pika 3, germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit): plotësuar.

- dokumentacioni i parashikuar në germën “d” (Vërtetimin e pagesës së aplikimit në llogari të ERE-s): plotësuar pjesërisht.



- dokumentacioni i parashikuar në nenin 9, pika 4.1.1 (Të dhëna teknike për HEC-et): plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të bëjë me dije në ERE afatin e jetëgjatësisë së pritshme të centralit,

do të njoftohet shoqëria që në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë ato në ERE brenda afateve.

- Në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE mund të lëshojë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total 14962 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 102, datë 24.6.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK LUNDRUES MBI REZERVUARIN E HEC “BANJA”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a” dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 75/7 prot., datë 16.6.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Statkraft Renewables Albania’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC “Banjë”, me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 753 prot., datë 9.6.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC “Banjë”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në datën 6.8.2018, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. është një subjekt përfaqësues në cilësinë e



mbajtësit të miratimit, i cili ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën me nr. 6077 rep., nr. 1657 kol., datë 19.12.2019, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiik lundruës mbi rezervuarin e HEC “Banjë”, Bashkia Cërrik, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me miratimin përfundimtar nr. 4657/2 prot., datë 31.5.2019, ka miratuar ndërtimin e centralit fotovoltaiik lundruës dhe veprave të tij ndihmëse mbi rezervuarin e HEC “Banjë”, Bashkia Cërrik, qarku Elbasan nga shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të ndryshuar, rezulton:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4 gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.5, gjerat “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni i parashikuar në nenin 9, pika 4.4.5, gjerat “a”), Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose të shpërndarjes): plotësuar. Subjekti ka depozituar pranë ERE-s “Miratim pikë lidhjeje, centrali fotovoltaiik lundruës” me nr. 4603/3 prot., datë 2.4.2019, për shoqërinë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. Në këtë miratim përcaktohet se ky central fotovoltaiik lundruës do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet linjës 35 kV, që lidh Nënstacionin Banjë me Nënstacionin Mjekës. Lidhja do të realizohet nëpërmjet një linje 35 kV të re me përcjellës ACSR dhe pajisjet përkatëse elektrike nga centrali deri te

pika e lidhjes që do të ndërtohet nga investitori. Matja e energjisë do të realizohet me matës statik me dy drejtime për energjinë reaktive sipas kërkesave të kodit të matjes.

- Dokumentacioni i parashikuar në neni 9, pika 4.4.5, gjerat “b”), (Leje mjedisore nga organet përkatëse): pa plotësuar. Në vijim do t’i kërkohe shoqërisë të përcjellë në ERE lejen mjedisore të lëshuar për këtë central.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

- Duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të hartuar për Centralin Fotovoltaiik lundruës të shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., rezulton se jetëgjatësia e një paneli është jo më shumë se 25 vjet, kohëzgjatja e licencës që ERE mund të miratojë për këtë subjekt nuk mund të jetë më shumë se 25 vjet.

- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit, në zbatim të rregullores “për Procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të ndryshuar.

Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, BORDI i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik lundruës mbi rezervuarin e HEC “Banjë”, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Për këtë vendim mund të kërkolet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 103, datë 24.6.2020

**MBI TË LICENCUARIT NË SEKTORIN
E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË
GAZIT NATYROR, TË CILËT NUK
KANË SHLYER PAGESAT
RREGULLATORE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave të marra pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë ERE, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e mundësisë (në kuadër të situatës të krijuar nga COVID-19), për shlyerjen e debisë brenda 30 ditëve, duke filluar nga data 24.6.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 212, datë 18.12.2019, “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2019”, ka miratuar pagesat rregullatore për vitin 2019 për secilën shoqëri të licencuar nga ERE.

- Nga analizimi i ecurisë së arkëtimit të pagesave rregullatore për vitin 2020, konstatohet se shumë prej tyre janë debitorë të detyrimeve për vitin 2019, por edhe debitorë për pagesa të pashlyera të viteve të mëparshme.

- ERE ka njoftuar të licencuarit për vlerën dhe afatet e pagesës rregullatore, në zbatim të nenit 17

të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me shkresë protokolluar me nr. 412./seri, datë 6.2.2020.

- Vendimi i ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.1.2020.

- Duke qenë se rezultojnë ende subjekte që nuk kanë kryer brenda afatit 30-ditor nga data e marrjes së njoftimit të ERE-s, pagesën rregullatore për vitin 2019 dhe disa prej tyre edhe pagesat rregullatore ndër vite, ERE-s i lind e drejta që për këta të licencuar të aplikojë masat administrative, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe rregulloren e miratuar për këtë qëllim.

- Qeveria shqiptare, me VKM-në nr. 243, datë 24.3.2020, ka shpallur “Gjendjen e fatkeqësisë natyrore”, e cila ka përfunduar në datë 23.6.2020.

- Qeveria shqiptare ka marrë një sërë masash me qëllim lehtësimin e procedurave administrative të subjekteve tregtare dhe personave fizikë gjatë periudhës së shtrirjes së efekteve kufizuese të gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë.

- Enti Rregullator i Energjisë, për shkak të rrethanave të krijuara nga COVID-19, me vendimin nr. 51, datë 26.3.2020, miratoi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave të marra dhe nga qeveria shqiptare pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë.

- Ndodhur në kushtet e një izolimi prej më shumë se dy muajsh, për shkak të pandemisë COVID-19, pezullimit apo ngrirjes së aktiviteteve në Republikën e Shqipërisë, është e arsyeshme që afatet e parashikuara, nga legjislacioni në fuqi, si dhe njoftimi i ERE-s drejtuar të licencuarve, për shlyerjen e debisë së krijuar, për shkak të moskryerjes në afat të pagesave rregullatore nga të licencuarit, të shtyhet për një kohë të mjaftueshme për të mundësuar shlyerjen e detyrimeve të pashlyera apo të prapambetura të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Shtyrjen deri në datën 31.7.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.7.2020.

3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të licencuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 1026/4, datë 20.7.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Mbrojtjes shpall kërkesën për shpronësim, “Për zbatimin e ligjit nr. 10256, datë 25.3.2010 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë Për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë””.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni pronarët e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 733,700 (shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
Petro Koçi



TABELA PARAPRAKE E PRONARIT, PËR PASURINË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHET SI PASOJË E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 10256, DATË 25.3.2010 “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR KËRKIMIN, ZHVARRIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE VARRIMIN E USHTARAKËVE GREKË, TË RËNË NË SHQIPËRI GJATË LUFTËS GREKO-ITALIANE TË VITEVE 1940–1941 DHE PËR NDËRTIMIN E VENDPREHJES PËR TA BRENDA TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Nr.	Emër mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m²)	Sip. truall e prekur (m²)	Çmimi truall (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m²)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Mitropolia e Shenjtë Gjyrokastër	Këlcyrë, Përmet	truall	2131	362	7150	2900		733,700	61	-	-	733,700	Konfirmuar nga ZVASHK Përmet më datë 23.10.2019
Vlera paraprake e shpronësimit							2900	253	733,700		-	-	733,700	

**NJOFTIM****Nr. 8313, datë 20.7.2020****MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bjellorusisë për heqjen reciproke të kërkesave për vizë”, nënshkruar më 27.12.2019, hyrë në fuqi më 15 korrik 2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 476 lekë